Dhuratë e revistës Etika

Vesë

Viti 4 • Numri 13 • Janar - Mars 2016

Xheneti është i rrethuar me vështirësi...

PROGRESI BOTIME
Shtëpia botuese Progresi vjen me 6 libra të rinj, të cilët do të ushqejnë botën tonë shpirtërore dhe do t'i japin drejtim jetës sonë individuale dhe shoqërore.
TË RINJ
Një këshillë 1001 mësime
350 Lekë
3 Euro
101 Parime në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro
Si edukonte Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro
SI EDUKONTE AI ?
Një Këshillë 1001 mësime
Osman Nuri Topbash
101 Parime në Shërbim
Osman Nuri TOPBASH
Shqetësimi për brezat
200 Lekë
1.5 Euro
SHQETËSIMI PËR BREZAT
Osman Nuri TOPBASH
Udhëtimi drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro
Udhëtimi drejt Zotit
NGA BESIMI NË MIRËSI
OSMAN NURI TOPBASH
Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro
Shërbimi
Osman Nuri Topbash
SHQIPËRI: Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 607 8484 | E-mail: rev.etika@gmail.com
KOSOVË: Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 4411 9848
MAQEDONI: Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245

Pasi Allahu Teala i fryu shpirtit të Ademit, (a.s.), i urdhëroi engjëjt që t'i bënin sexhde. Në atë kohë mes xhindëve, të cilët u komunikuan për këtë urdhër, ishte edhe Iblisi. Edhe pse të gjithë engjëjt i bënë sexhde, Iblisi nuk i bëri. Ngaqë e kundërshtoi urdhrin e Allahut Teala, u dëbua nga xheneti e nga vendi i mirësive të pafundme dhe u mallkua. Ndërsa ai i kërkoi kohë dhe leje Allahut Teala që deri në Kiamet t'i zvarrisë në devijim Ademin dhe pasardhësit e tij. Si nevojë për sprovën Allahu Teala ia dha këtë leje djallit.

Që atë ditë djalli mundohet në rrugë dhe mashtrime të ndryshme ta nxjerrë njeriun nga rruga e udhëzimit. Deri sa njerëzit të japin frymën e fundit, djalli nuk u ndahet dhe nuk e humb shpresën.

Djalli dhe ushtria e tij së pari mundohet ta çojë njeriun në devijim dhe mohim. Nëse ia arrin kësaj, mundohet për të rritur gradën e mohimit dhe thellësinë e batakut të mëkatit. Nëse edhe kësaj ia del, largohet prej tij "Duke u druajtur nga thellësia e mohimit të njeriut dhe mostrembja e tij në rebelim". Pothuajse thotë: "Ti ma kalove edhe mua; unë kam frikë Allahun e nuk mund të bëhem kaq i lig!"

Nëse nuk mund ta çojë njeriun në devijim, mohim dhe rebelim, mundohet të fusë dyshime në besimin e tij dhe vesvese në veprat e tij. Mundohet ta mbajë larg nga punët e devotshme, veprat e mira, adhurimet dhe miqtë e mirë.

Nëse edhe këtë nuk mund ta arrijë, mundohet t'ia krimbë adhurimet dhe shërbimet fetare. Ai i vendos mburrje, mendjemadhësi, egoizëm e krenari në zemër duke i thënë: "Sa njeri i madh që je! Sa punë të mëdha që ke bërë!.." E bën ta shohë veten të madh, ndërsa të tjerët të vegjël. Nëse edhe këtë nuk e arrin dot, e bën të përgojojë dhe të flasë për të tjerët.

Duke shfrytëzuar çdo rast mundohet të hyjë në zemrën e atij njeriu. Nganjëherë mundohet ta bëjë njeriun që t'i lërë adhurimet, t'i neglizhojë ose t'i kryejë me mangësi, duke i dalë atij përpara me petkun e nënës, fëmijëve, bashkëshortit-es apo mikut të tij.

Nëse robi e mbron sinqeritetin dhe devotshmërinë ashtu siç mbron besimin, djalli ngel i dobët. Tashmë tërhiqet nga ai person dhe fillon të kërkojë dyer të tjera. Por në fakt atë nuk e braktis plotësisht. Ai pothuajse qëndron në pritë dhe shfrytëzon çdo rast për ta devijuar atë.

VITI: III
NUMRI: 12
Tetor-Dhjetor
2015

BOTUESI
Shtëpia Botuese "Progresi"
DREJTOR
Albert Halili
KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj
PËRKTHYES
Ernida Kraja | Eva Kajti
Naile Sulaj
DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
L: Vasil Shanto; Rr: Çajupi
Shkodër; Shqipëri
MOBILE
+355 67 607 8484
E-MAIL
rev.etika@gmail. com

Përmbajtja

I dashur njeri — Ela Muça — 38

Mbretëria e modestisë — Osman Nuri Topbash — 20

Cilësitë e shejtanit — Melike Shahin — 12

Fillimi i historisë së njerëzimit — Fatma Nur Xhihan — 5

Të kesh frikë nga djalli — Fatma Hale Liman — 8

Nëse e kundërshton djallin, besimi forcohet — Kubra Çoban — 14

Djalli dhe sulmet e tij — Tuba Çënar — 15

Respekti ndaj xhumasë dhe as'habu's-sebt — Aishe Gënyl Bejaz — 16

Nëse ti nuk je më e bukur se hëna, divorcohu! — Halime Demireshik — 17

Mbulimi i avretit në namaz — Kevser Atar — 24

Mëshiroje jetimin — Zahide Topçu — 27

Klithma e fqinjit të uritur — Shefika Kaja Meriç — 28

Fjalët e një gjembi — Elif Menxhet — 30

Zëri i lutjes — Servete Dërguti — 32

Bëj një ushqim të tillë që... — Aishe Tunçajak — 34

Fatma Nur Cihan

FILLIMI I HISTORISË SË NJERËZIMIT

Njeriu i parë dhe fillimi i llojit njerëzor... Kundërshtimi i parë, dëbimi i parë... Mëkati i parë që bëri njeriu dhe pendimi i tij i parë... Ngjarje që pothuajse i dimë të gjithë... Le t'u hedhim një sy këtyre edhe nën udhëzimin e Kuranit Famëlartë.

Babai i njerëzimit

Kurani Famëlartë njofton se të gjithë njerëzit janë bijtë e Ademit:

"O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra." (Nisa, 1)

Atëherë, të gjithë njerëzit që nga i pari e deri te i fundit që do të vijnë deri në Kiamet, janë fëmijët e Ademit, (a.s.), domethënë, fëmijët e një pejgamberi... Njerëzit nuk janë krijesa të krijuara rastësisht. Ata janë fëmijët e një njeriu të zgjedhur që Allahu i Madhëruar e ka krijuar në veçanti, domethënë, fëmijët

e një pejgamberi... Ne duhet të përpiqemi t'i japim hakun dhe të mos e njollosim këtë pozitë që Allahu, xhelle xhelaluhu, na ka dhuruar.

Mëkëmbësi në tokë

Allahu i Madhëruar i njoftoi kështu engjëjt kur deshi të krijonte njeriun:

"Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë do të krijoj një mëkëmbës *(që do të zbatojë ligjet e Zotit)* ***në tokë..."*** (Bakara, 30)

Për shkak të përvojave që engjëjt kishin përjetuar, apo nga të dhënat e levhi mahfudh-it, apo ngaqë nuk e kuptuan plotësisht natyrën e njeriut, thanë:

"...Ata thanë: "A do të krijosh dikë që do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?!.." Allahu Teala u tha:

"Unë di atë që ju nuk e dini". (Bakara, 30)

Pastaj engjëjt shfaqën paaftësinë e tyre kundrejt Allahut Teala, duke e falënderuar Atë të gjithë së bashku. (Bakara, 31-33)

Domethënë, njeriu është krijuar për të qenë mëkëmbësi i Allahut Teala në tokë. Kuptimi i kësaj mëkëmbësie është (vekili) njeriu që përfaqëson vullnetin e Allahut të Madhëruar në tokë dhe që zbaton urdhrat e ndalesat e Tij.

Pastaj Allahu Teala e krijoi Ademin, (a.s.), nga dheu (nga një baltë e thatë dhe nga argjila e formuar). Pastaj i tha: ***"Bëhu!"***, dhe ai ***"u bë"***. (Shik: Al Imran, 59; Hixhr, 28.)

Urdhri i parë dhe mëkati i parë

Kur Allahu i Madhëruar e krijoi nga balta trupin e Ademit (a.s.) dhe i fryu prej shpirtit të Tij, i urdhëroi engjëjt që t'i bënin sexhde. (Hixhr, 29)

Fryma e shpirtit te Ademi (a.s.) para së gjithash tregon nderin dhe vlerën që Allahu Teala i ka dhënë njeriut. Kjo tregon aspektin e etjes së njeriut për sublimen dhe të aftësisë së tij për t'u lartësuar drejt qiejve. Edhe krijimi i njeriut nga toka, tregon aspektin suli të tij, domethënë, aspektin e dëshirave vetjake të tij. Nisur nga gjendja shpirtërore e tij, njeriu është ndërmjet dy poleve të kundërta, domethënë, ndërmjet ligësisë dhe devotshmërisë. (Shik: esh-Shems, 7-10.)

Kur Allahu i Madhëruar i fryu shpirtin trupit të Ademit, të gjithë engjëjt i bënë sexhde atij. Përveç Iblisit... (Hixhr, 30-31; A'raf, 11.) Iblisi ishte njëri prej xhindeve që jetonte bashkë me engjëjt në xhenet deri atë kohë. (Kehf, 50)

Kur Iblisi nuk i bëri sexhde Ademit, Allahu i Madhëruar e pyeti: "Përse nuk i bëre sexhde?" (Shik. El-Hixhr, 32; Sad, 75.)

Ai (shejtani) u përgjigj:

"Unë nuk i përulem një njeriu që Ti e ke krijuar nga balta e thatë e marrë prej baltës së zezë të formuar." (Hixhr, 33)

"Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga balta". (A'raf, 12; Hixhr, 33; Sad, 76.)

Allahu Teala i dha këtë përgjigje kundërshtimit plot mendjemadhësi e krenari të shejtanit:

"...Atëherë, dil prej xhenetit! Ti je vërtet i mallkuar! Le të jetë mallkimi mbi ty deri në Ditën e Kiametit!" (Hixhr, 34-35)

Ndërsa në një ajet tjetër, njoftohet se i ka thënë kështu:

"...Atëherë, zbrit prej andej *(xhenetit)**!** **Ti nuk ke të drejtë që të mburresh në të! Shporru, me të vërtetë, ti je prej të poshtëruarve".*** (A'raf, 13; Sad, 77-78.)

Atëherë, të gjithë njerëzit që nga i pari e deri te i fundit që do të vijnë deri në Kiamet, janë fëmijët e Ademit, (a.s.), domethënë, fëmijët e një pejgamberi...

Koha që iu dha shejtanit

Shejtani, që u përzu nga xheneti dhe nga mëshira e Allahut Teala në këtë mënyrë, kërkoi kohë deri në Kiamet për të devijuar Ademin dhe pasardhësit e tij. Allahu i Madhëruar i dha leje atij deri në kohën e Kiametit. (Hixhr, 36-38; A'raf, 14-15.)

Urtësia e dhënies së kësaj kohe shejtanit është dalja në pah e "farërave të mirësisë dhe të ligësisë" që gjenden te njeriu në një formë të fshehtë në jetën e kësaj bote, e cila është një botë sprovimi dhe ekzistenca e një armiku kundrejt të cilit njeriu mund të përdorë fuqinë, vullnetin dhe mendjen e tij. Në këtë mënyrë, njeriu do të njohë veten e tij dhe do të përpiqet që të meritojë mirësinë e xhenetit dhe shikimin e Allahut Teala sipas mundimit që ka shfaqur.

Shejtani nuk e pranoi gabimin që bëri dhe sikur po sfidonte Zotin, xhelle xhelaluh, tha:

"Për shkak se Ti më flake tej, unë do t'u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë *(për t'i devijuar ata)****."*** (A'raf, 16)

"O Zot! Për shkak se më çove në humbje, unë do t'ua zbukuroj atyre *(njerëzve)* ***rrugën e gabuar në tokë dhe të gjithë do t'i shpie në mashtrim."*** (Hixhr, 39)

Shejtani është armiku ynë

Pasi shejtani e shprehu armiqësinë e tij kundrejt njerëzve, Allahu i Madhëruar ia paraqiti atë Ademit dhe pasardhësve të tij si një armik:

"Pastaj thamë: "O Adem! Me të vërtetë që ky është armiku yt dhe i gruas tënde, prandaj kurrsesi mos e lini t'ju nxjerrë nga xheneti, se pastaj do të vuani në mjerim!" (Ta Ha, 117)

"Me të vërtetë, djalli është armik për ju, andaj vështrojeni si armik! Ai vetëm i josh ithtarët e vet, që të bëhen shokë të zjarrit të përflakur." (Fatir, 6)

Fruti i ndaluar

Njerëzit e parë ndaj të cilëve shejtani e shfaqi armiqësinë e tij, ishin Ademi dhe nëna jonë, Havaja. Ata hanin dhe pinin sa të dëshironin nga gjërat e xhenetit dhe jetonin aty të qetë. (Ta Ha, 118-119) Por Allahu Teala i ndaloi ata që t'i afroheshin një pemë në xhenet, në mënyrë që t'i sprovonte. (A'raf, 19) Kjo nga njëra anë ishte një sprovim për Ademin, (a.s.), e nënën tonë, Havanë dhe nga ana tjetër ishte një mundësi për djallin e mallkuar.

Shejtani iu afrua Ademit dhe bashkëshortes së tij, u dha premtime të ndryshme dhe i bëri që të hanin nga fruti i pemës së ndaluar duke iu betuar atyre. (Ta Ha, 120) Kjo çështje tregohet kështu në ajetet fisnike:

"Djalli u pëshpëriti, për t'ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre dhe u tha: "Zoti jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm." Dhe iu betua atyre *(duke thënë)****:***

"Vërtet, Unë jam për ju këshillues i sinqertë!" Dhe i mashtroi me dinakërinë e tij. Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbulohen me gjethet e xhenetit. Pastaj Zoti i tyre i thirri: "A nuk jua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapët?" (A'raf, 20-22)

Pendimi i Ademit dhe Havasë

Për shkak të natyrës së tij, shejtani nuk e zbatoi urdhrin e Allahut Teala dhe mëkatoi. Edhe Ademi, (a.s.), mëkatoi duke e shkelur një ndalesë të Tij. Por edhe pse në fillim ka një gjendje të ngjashme, pas kësaj çështjeje del në pah virtyti i Ademit dhe i nënës sonë, Havasë, shejtani pasi e bëri gabimin, fajësoi Allahun për këtë dhe i tha: "Ti më devijove mua." Në këtë mënyrë e shtoi mëkatin dhe kërkoi leje që t'i shtojë mëkate të reja mëkatit të vjetër. Ndërsa Ademi dhe Havaja e pranuan gabimin që bënë, u penduan dhe filluan ta lusin Allahun Teala që t'i falte. Kjo gjendje shprehet kështu në ajetin fisnik:

"O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet do të jemi prej të humburve". (A'raf, 23)

Allahu Teala ua pranoi pendimin atyre, por i zbriti në tokë si ndëshkim për gabimin që bënë. Edhe për këtë çështje, në ajetin fisnik thuhet:

"Zbrisni! Ju do të jeni armiq me njëri-tjetrin. Në tokë do të banoni dhe do të jetoni deri në një kohë të caktuar. Aty do të jetoni, aty do të vdisni dhe prej saj do të ringjalleni." (A'raf, 24-25)

Së fundi, po e përfundoj me paralajmërimin që Allahu u bëri të gjithë njerëzve duke bërë krahasim me gjendjen e Ademit dhe nënës sonë, Havasë:

"O bijtë e Ademit, le të mos ju mashtrojë kurrsesi djalli, ashtu si i nxori prindërit tuaj nga xheneti, duke ua zhveshur rrobat për t'u dukur vendet e turpshme! Ai dhe shpura e tij ju sheh, prej nga ju nuk i shihni ata. Ne i kemi bërë djajtë miq të atyre që nuk besojnë." (A'raf, 27)

Fatma Hale Liman

Të kesh frikë nga djalli

Një herë m'u dha rasti t'u jepja mësim në lëndën e akides nxënëseve të njërit prej kurseve tona verore të Kuranit. Ndërkohë që po shpjegoja se çfarë temash shtjellon lënda e akides, të gjitha nxënëset u fokusuan te djajtë dhe xhindet. Megjithëse ndërmjet temave që do të shtjellonim ishte edhe çështja e shejtanit / xhindeve, unë dëshiroja që nxënëset të merreshin më shumë me temat si besimi te Allahu dhe besimi në ahiret, por fjalët që thoshin njëzëri për shejtanin nxënëset me mosha të ndryshme ndërmjet 14-15 vjetëve e që vinin në Kursin e Kuranit nga vende të ndryshme dhe forma e shejtanit / xhindit që kishin në mendjet e tyre, më tmerroi mua dhe dëshirat e mia i mori era. Frikësoheshin aq shumë nga xhindet dhe djajtë, saqë flisnin për ta vetëm duke i përmendur si "tre shkronjëshat". Ndërsa fjalët që thoshin për shejtanin ishin:

"Në këtë botë bëhet vetëm çfarë thonë të këqijtë e jo të mirët. Djalli është shumë i fortë. A nuk kujdeset Allahu Teala për të mirët?"

"Djalli ka fuqi shumë të madhe dhe forcë për të na nxjerrë ne nga rruga e drejtë. Ne jemi shumë të dobët, a mund t'i bëjmë ballë atij?"

"Ekziston një besim që quhet satanizëm, në të cilin adhurohet djalli. Besimtarët e këtij besimi presin mace dhe mbajnë mesha. Me këtë mbrohen nga ligësitë e djallit dhe kërkojnë të bëhen posedues të fuqisë së tij. A është e mundur kjo?"

"Pse Allahu nuk u jep shanse të mirëve, por të këqijve? A punon djalli më shumë se engjëjt? A flenë këta engjëjt? Pse nuk na mbrojnë?"

"Kudo të ligjtë janë më të fuqishëm se të mirët. A e marrin nga djalli këtë forcë?"

"Djalli nuk është i vetëm. Ai ka edhe ushtrinë e tij. Na ndjek vazhdimisht, jeton me ne dhe nuk shkon askund. Kjo është diçka shumë e frikshme! Nuk ikën, edhe sikur ta dëbojmë. Është vendosur mirë... Është shumë e vështirë t'i bësh ballë. Edhe Hz. Adem (a.s.) dhe Hz. Hava nuk mundën t'i bëjnë ballë dhe u dëbuan nga xheneti. Për shkak të tij edhe ne nuk do të mund të hyjmë në xhenet."

"Folëm aq shumë për të. A do të hakmerret ai tani?"

Këto biseda që bëheshin rreth një krijese të vdekshme që e ka krijuar Allahu Teala dhe kaderi i së cilës është në dorë të Allahut me besimin se Allahu është i pafuqishëm ndërsa shejtani është shumë i fuqishëm, nxirrte në pah se besimi që nxënëset kishin te Allahu i Madhëruar, ishte shumë i dobët. Për shkak se është shirk "të duash dikë aq sa Allahun Teala" apo "të kesh frikë nga dikush aq sa nga Allahu", pa e ditur, këta fëmijë përjetonin një problem besimi duke e parë Allahun të pamjaftueshëm (Allahu na faltë), ndërsa shejtanin shumë të fuqishëm.

Ato flisnin si krijesa të shkreta dhe që nuk e dinin vlerën e tyre te Allahu i Lartësuar. Kur bëhej fjalë për shejtanin, edhe pse e dinin fuqinë e Allahut Teala, menjëherë ndryshonte çdo gjë... Ndoshta edhe ne mund të kemi ndonjë gabim në mënyrën e shpjegimit të shejtanit, ngaqë ato e shikonin në formë shumë ekstreme këtë krijesë të përkohshme dhe që ndjek kaderin të cilin ia ka përcaktuar Allahu Teala.

Nxënëseve u thosha që t'u përkushtohemi këtyre fjalive:

"Asnjë krijesë nuk ka fuqi sa Allahu (xh.xh.)."

"Shejtani nuk ka të njëjtin ndikim te çdo njeri."

"Xhindet dhe njerëzit janë obliguar me adhurim ndaj Allahut Teala dhe janë përgjegjës për ato që veprojnë. Si janë bërë kaq të këqij popujt e xhindeve të cilët janë krijuar shumë para njeriut dhe kanë derdhur shumë gjak në tokë, ndërkohë që shejtani nuk ishte përzier në punët e tyre? Ndërkohë që shejtani përzihet në punët e njeriut dhe është armiku ynë që na shpie në ligësi, si ka mundësi që xhindet e pavarur nga shejtani, bënë vepra të këqija, shkaktuan probleme në tokë dhe derdhën gjak në të? Apo njeriu dhe xhindet kanë ndonjë armik më të rrezikshëm se shejtani që i zvarrit ata në ligësi?"

"Shejtani ka aq shumë frikë nga Allahu Teala, saqë mund t'i plasë tëmthi. Këtë mund ta kuptojmë nga fjalët e shejtanit të cilat i shpreh në Kuran Allahu i Madhëruar. Atëherë, a nuk është një kontradiktë fakti që ai ka frikë nga Allahu, xhelle xhelaluhu, ndërsa ne kemi frikë nga ai?"

Të këqijat që mund të bëjë një njeri i cili e ka veten në gradën e nefsit emmare (nefsi që urdhëron të keqen), e lë shumë pas shejtanin. Ne që vazhdojmë të mos e kuptojmë nefsin emmare që e kemi ushqyer dhe nuk e kemi vënë në rrugë të drejtë duke e edukuar, e harrojmë atë dhe shejtanin i cili nuk ka asnjë lloj kuptimi pa nefsin emmare, e pranojmë si armikun më kryesor dhe friksohemi nga ai. A do ta dëgjonte shejtanin nefsi i Hazreti Ademit, alejhisselam, sikur të mos dëshironte të ishte i pavdekshëm? Pasi Hazreti Ademi e bëri këtë gabim, nuk tha:

"Shejtan i pafytyrë!.. Çfarëdo që bëra, e bëra ngaqë më mashtrove ti. Ti u bërë shkak që u përzura nga xheneti. Të lutem o Zot! Ndëshkoje shejtanin!.. Ti e di se unë nuk kam asnjë faj!.." Por u pendua duke shprehur fjali që fillojnë:

"Unë i bëra padrejtësi vetes sime."

Edhe Hazreti Junusi, alejhisselam, në barkun e peshkut, nuk ia hodhi fajin shejtanit dhe të strukej në një qoshe, por u pendua në këtë mënyrë:

"O Zot që nuk ka tjetër përveç Teje! Ti je i pastër nga çdo lloj mangësie, ndërsa unë u bëra prej të padrejtëve."

Patjetër që djalli nuk është i pafajshëm!.. Është e sigurt se ai nuk na do dhe se vazhdimisht mundohet të na devijojë... Por përderisa njeriu bën kujdes ndaj haramit dhe hallallit, ai nuk mund të ndikojë...

Si mund të ndikojë shejtani te ne kur kemi ajetin fisnik në të cilin Allahu i Madhëruar, thotë:

"O njerëz! Ushqehuni me të gjitha ato gjëra të lejuara e të mira që gjenden në Tokë dhe mos ndiqni gjurmët e djallit, sepse ai është njëmend armiku juaj i hapur." (Bakara, 168)

Kur njeriu është afër Allahut Teala me një besim të dëlirë e të sinqertë...

Iblisi tha: "Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t'jua zbukuroj atyre *(njerëzve)* ***rrugën e gabuar në tokë dhe të gjithë do t'i shpie në mashtrim, përveç robërve të Tu të sinqertë".*** (Hixhr, 39-40)

A mund të ndikojë djalli i mallkuar tek njerëzit ndërkohë që ekziston ajeti fisnik në të cilin thuhet:

"Ata që i frikësohen Allahut, kur u vjen ndonjë mendim i lig nga djalli, i kujtojnë *(urdhrat e Tij)*, ***e atëherë e shohin rrugën e drejtë."*** (Araf, 201)

Ndërkohë që e frenojmë nefsin tonë, ia mbyllim dyert e hyrjes djallit. Ndërkohë që, nëse gabojmë, derdhim lot, qajmë dhe pendohemi…

"Përjashtim bën ai që pendohet, beson dhe punon vepra të mira. Një njeriu të tillë Allahu ia ndërron veprat e këqija në të mira. Allahu është Falës e Mëshirëplotë." (Furkan, 70)

Çfarë mund të bëjë djalli tjetër përveç paaftësisë dhe dobësisë nëse strehohemi te Allahu Teala i Cili është Rrahman, Rrahim, Gafur, Rauf, Gaffar, Afuvv, Tevvab?! Ndërkohë që ekzistojnë ajetet:

Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve, Sundimtari i njerëzve, i Adhuruari** (i vetëm me të drejtë) **i njerëzve, nga sherri i djallit cytës që fshihet** (pasi cyt) **e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve…" (Nas, 1-5)

Ndërkohë që është Allahu i Cili thotë se mashtrimi i djallit është i dobët...

"Ata që besojnë, luftojnë në rrugën e Allahut, kurse ata që nuk besojnë, luftojnë në rrugën e djallit. Luftoni kundër ithtarëve të djallit, sepse vërtet, dinakëria e djallit është e dobët!" (Nisa, 76)

*"(Allahu) **tha: "Kjo është rruga Ime e drejtë. Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robërit e Mi, përveçse mbi të humburit, që të pasojnë ty. Pa dyshim, Xhehenemi është vendi i premtuar për të gjithë ata."***
(Hixhr, 41-43)

Si mund të thotë njeriu "ne jemi shumë të dobët dhe konfuzë përballë djallit", ndërkohë që ekziston ajeti:

"Vetëm djalli i frikëson ithtarët e vet. Ju mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!" (Al-i Imran, 175)

Kur një rob mëkaton duke dëgjuar djallin dhe më pas derdh lot sinqeriteti, falet nga Allahu (xh.xh). Kur robërit të cilët bëhen krejt të pastër duke shpëtuar nga të gjitha mëkatet e jetës me një haxh dhe umre të pranuar, a nuk e bëjnë djallin një krijesë të dobët përpjekjet e të cilit shkojnë të gjitha dëm?

Aty ku është i dobët nefsi ynë, aty ku nefsi ynë ka lënë derë hapur, ja nga ato dyer mund të hyjë brenda djalli. Dera e zemërimit, dera e urrejtjes, dera e ambicies, dera e frikës së urisë, dera e dëshirës për të jetuar gjatë, dera e dëshirës për të qenë i fortë, dera e ambicies për para, dera e pasurisë, dera e dëshirës për të qenë i famshëm etj.

Shumë mësimdhënëse janë edhe këta rreshta të Mesnevisë së Hazreti Mevlanës, kuddisallahu sirruh:

"Nefsi dhe djalli ishin një esencialisht. Ata e treguan veten në dy forma të ndryshme. O njeri, ke brenda një armik aq të madh i cili e pengon mendjen të marrë masa dhe është hasëm i shpirtit e fesë tënde. Ai armik për një çast të sulmon si hardhucë, pastaj ikën e fshihet në ndonjë vrimë."

Për të hyrë në zemrën e njeriut ekzistojnë një sërë vrimash shpirtërore. Ai e nxjerr kokën në krye të secilës nga këto vrima. Fshehja e shejtanit nga njeriu dhe dalja e tij nga vrimat shpirtërore në zemër, quhet Hunus. Allahu i Madhëruar e ka quajtur shejtanin "Hannas", sepse sulmi që shejtani i bën zemrës dhe tërheqja e tij, i ngjan kokës së iriqit që e nxjerr dhe e fut brenda menjëherë. Për shkak të kësaj dredhie, gjarpri është më i dobët se ai.

Si mund të të mposhtnin kriminelët e rrugës (shejtanët), sikur mos të ta godiste rrugën tënde vetja që ke brenda? Për shkak të epshit dhe atij punëtori të fshehtë që të shpien në rrugë të keqe, zemra është rob i tamahut, lakmisë dhe shkatërrimit. Njeriu vjedh për shkak të ligësisë që ia kërkon vetja e cila është një punëtore e fshehtë dhe në këtë mënyrë, shkatërrohet. Përsëri, punëtorët që janë jashtë e gjejnë rrugën për të të shkatërruar për shkak të saj. Dëgjoje këtë këshillë të mirë e të bukur nga hadithin në të cilin i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

"Armiku yt më i tmerrshëm është vetja që ke brenda."

Mos i dëgjo fjalët zhurmuese të armikut vete dhe largohu nga ajo, sepse edhe ajo bën inat dhe këmbëngul si shejtani. Nefsi ta tregon të lehtë ndëshkimin e përhershëm në ahiret për shkak të dashurisë së kësaj bote

dhe luftës për sigurimin e jetesës në këtë dynja.

Nuk është e habitshme që nefsi të ta shfaqë të lehtë edhe vdekjen, sepse ai bën më shumë se kaq me magjinë dhe joshjen e saj. Nganjëherë vetja, me anë të artit të saj, e bën qimen tra dhe nganjëherë e bën traun qime. Nefsi dhe shejtani, me artin dhe dredhitë e tyre, nganjëherë t'i shfaqin të mira gjërat e shëmtuara. Po ashtu, edhe gjërat e mira nganjëherë të bëjnë t'i pandehësh si gjëra të shëmtuara.

Një magjistar i tillë është brenda teje. Ajo është vetja që të bën vesvese si shejtani. Në vesveset e saj ka një magji të fshehtë. Në këtë botë veçanërisht ka edhe magjistarë të tillë që i prishin këto magji. Bir! Në shkretëtirë ka lindur kundërhelmi (profeti, evlijatë) ndaj këtij helmi të magjisë. Kundërhelmi të thotë:

"Kërkoje dhe merre nga unë moralin e lartë! Unë jam më i afërt dhe më i mirë për ty se helmi. Fjala e vetes dhe e shejtanit është magji. Kështu që të shkatërron. Ndërsa fjala ime është një e vërtetë e tillë që e shkatërron magjinë e tyre." (Mesnevi, bejtet 11706-11731.)

Përgjegjësi i gabimeve që bëjmë, jemi ne dhe jo shejtani... Sikur të ishte kështu, do të thoshim: "Më mashtroi djalli" dhe kështu do të shpëtonim. Por nuk mund të shpëtojmë, ngaqë nuk është kështu. Kjo tregon se Allahu, xhelle xhelaluhu, nuk e pranon si justifikim fjalinë: "Shejtani më mashtroi. Ai është përgjegjës për këtë."

Njëra prej nxënëseve të kursit veror, tha:

"A s'e keni marrë shejtanin si shumë lehtë mësuese? Edhe ju jeni poshtë normales në këtë çështje?" Unë i thashë:

"Asgjë nuk kam marrë lehtë. Detyra jonë e vetme është që të mos madhërojmë apo lavdërojmë asnjë gjë kundrejt madhështisë së Allahut Teala dhe të mos kemi frikë nga asnjë duke u strehuar te Fuqia e Tij."

Sepse në ajetin fisnik, thuhet:

"Në të vërtetë, djalli nuk ka kurrfarë pushteti mbi ata që besojnë dhe mbështeten tek Zoti i tyre. Pushteti i djallit është vetëm mbi ata, që i binden atij dhe adhurojnë zota të tjerë veç Allahut." (Nahl, 99-100)

Njëra prej çështjeve më të rëndësishme që mund ta dobësojnë ndikimin e shejtanit mbi njeriun është përpjekja për ta njohur shumë mirë Allahun Teala. Ne duhet ta pranojmë si pasurinë më të madhe dhe mirësinë më të pashoqe, njohjen e vetes sonë, dredhitë e saj, pendimin dhe strehimin te Allahu i Madhëruar. Po ashtu duhet ta dimë mirë se nxitimi drejt hallallit dhe largimi nga harami sikur po ikim nga luani, e shkatërrojnë shejtanin. Në këtë mënyrë, duhet të jemi shumë të kujdesshëm veçanërisht ndaj gjërave që hamë e pimë dhe duhet të jemi të sinqertë.

Shejtani ka shumë frikë nga Allahu Teala. Në ajetin fisnik kjo gjendje njoftohet kështu:

"Djalli ua zbukuroi atyre veprat e këqija dhe u tha: 'Askush në botë nuk do t'ju mundë sot dhe unë jam mbrojtësi juaj'. Mirëpo, kur u ndeshën dy ushtritë *(me engjëjt përkrah besimtarëve)****, ai u kthye nga thembrat e tij dhe u tha*** *(jobesimtarëve)****:***

'Unë nuk kam të bëj me ju; unë shoh atë që ju nuk e shihni dhe i frikësohem Allahut, sepse Allahu ndëshkon ashpër'" (Enfal, 48)

Ndërkohë që djalli thotë kështu, si ka mundësi që njerëzit nuk kanë frikë nga Allahu, por nga shejtani dhe besojnë në satanizëm?

Ne nuk e neglizhojmë djallin, por as nuk e çmojmë më shumë se ç'duhet. Ajetet Në Kuranin Famëlartë dhe hadithet e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selen, na e sqarojnë çdo gjë shumë bukur. Robit i mbetet t'i njohë mirë këto dhe të bëhet i zgjuar. Një moment neglizhence nga ana jonë e forcon djallin dhe nefsin tonë. Ne mund t'i sfidojmë armiqtë tanë duke qenë të sinqertë dhe me pendim.

Jeta e kësaj bote është një fushë beteje që bëjmë me nefsin tonë dhe djallin... Fitorja e luftës mund të arrihet me ndihmën e Allahut Teala dhe ndjeshmërinë e robit... Allahu i bëftë të gjithë besimtarët fitimtarë në këtë fushë beteje. Amin!

Cilësitë e Shejtanit

Melike Shahin

Shejtani është mendjemadh

Kur u krijua Ademi, (a.s.), Allahu Teala i urdhëroi engjëjt dhe Iblisin që t'i bënin sexhde Ademit, por Iblisi nuk i bëri sexhde, edhe pse engjëjt e zbatuan urdhrin hyjnor. (A'raf, 11) Ai nuk iu bind urdhrit të Allahut (xh.xh.), shfaqi mendjemadhësi dhe u bë prej mohuesve. (Bakara, 34; A'raf, 12; Isra, 61; Sad, 75-76.)

Shejtani është mosmirënjohës ndaj Zotit (xh.sh.)

Shejtani është mosmirënjohës ndaj mirësive të Allahut të Madhëruar. (Isra, 27) Shejtani mëkatoi ndaj Allahut Teala, që është shumë i mëshirshëm. (Merjem, 44)

Ai i devijon njerëzit

Shejtani është shkaku që Ademi dhe Havaja gabuan dhe u larguan nga xheneti. (Bakara, 36; A'raf, 20.) Shejtani që e mashtroi njeriun e parë për ta bërë këtë gabim, e ka shpallur armiqësinë e tij edhe ndaj të gjithë njerëzve dhe është shprehur se do të bëjë çdo gjë që mundet për t'i futur edhe ata në xhehenem. (Nisa, 118) Shejtani i urdhëron njerëzit ta prishin natyrshmërinë e tyre që e ka krijuar Allahu Teala. (Nisa, 119) Shejtani i zbukuron mëkatet. (En'am, 43; Enfal, 48; Hixhr, 39; Nahl, 63; Neml, 24; Ankebut, 38.) Shejtani urdhëron për imoralitet dhe ligësi. (Nur, 21) Mëkatet e ndihmojnë shejtanin për t'i devijuar njerëzit. (Ali Imran, 155) Mbrojtja prej kurtheve të shejtanit arrihet me mirësinë e Allahut të Madhëruar. (Nisa, 83; Nur, 21.) Allahu Teala i ka larguar cytjet e Shejtanit prej zemrave të besimtarëve dhe i ka lidhur fort ato me njëra-tjetrën. (Enfal, 11) Shejtani e braktis njeriun dhe e poshtëron atë. (Furkan, 29) Shejtani e mposht atë që neglizhon dhikrin e Allahut Teala. (Zuhruf, 36; Muxhadele, 19.)

Shejtani është një armik i hapur i njeriut

Në shumë ajete fisnike të Kuranit, Allahu Teala ia përkujton njeriut armiqësinë e hapur të shejtanit. (Bakara, 168; Bakara, 208; A'raf, 22; Jusuf, 5.) Shejtanët prej xhindeve dhe prej njerëzve kanë ndërhyrë edhe te pejgamberët. (En'am, 112; Haxhxh, 52.) I Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte urdhëruar që të kërkojë ndihmë e strehim nga Allahu i Madhëruar kur shejtani t'i bënte vesvese. (A'raf, 200; Fussilet, 36.) Njeriu është ndaluar të adhurojë shejtanin. (Jasin, 60) Pasimi i shejtanit dhe i njerëzve të tij, është ndaluar nga Allahu (xh.xh.). (En'am, 142) Pasi shejtani i lëshon njerëzit në humbje, thotë: **"Unë nuk kam të bëj me ju, unë kam frikë Allahun!"** (Enfal, 48; Ibrahim, 22; Hashr, 16.)

Shejtani ndërhyn te vëllezërit dhe i ngatërron ata

Shejtani i ngatërron njerëzit, veçanërisht vëllezërit... (Jusuf, 100) Kur besimtarët të kuvendojnë ndërmjet tyre, duhet të flasin në mënyrën më elokuente. Përndryshe, armiku i ngatërron ata. (Isra, 53)

Shejtani është ulur mbi rrugën e drejtë të Allahut Teala

Shejtani është ulur mbi rrugën e udhëzimit për të devijuar njerëzit. (A'raf, 16) Shejtani i ndalon njerëzit nga rruga e Allahut dhe nga sexhdeja ndaj Tij. (Neml, 25) Shejtani e mashtron njeriun duke e sugjeruar atë që t'i besojë (më shumë se duhet) faljes së Allahut (xh.xh.). (Lukman, 33)

Shejtani përpiqet ta mbajë njeriun larg

veprave të mira

Shejtanët i frikësojnë njerëzit me varfëri, nëse ata japin në rrugë të Allahut prej pasurisë së tyre. (Bakara, 268) Ata i bëjnë njerëzit që t'i harrojnë punët e mira. (En'am, 68) Njerëzit e devotshëm kthehen menjëherë te Allahu Teala kur shohin se shejtani po u bën vesvese. (A'raf, 201)

Ne duhet t'i lutemi Allahut për të mbrojtur fëmijët tanë nga shejtani

Kur nëna e Merjemes e solli në jetë atë, iu lut Allahut Teala që ta mbrojë atë dhe pasardhësit e saj prej shejtanit. (Ali Imran, 36) Kur të fillojmë të lexojmë Kuran, duhet t'i kërkojmë mbrojtje Allahut nga shejtani i mallkuar. (Nahl, 98) Shejtani ka ortakëri në pasuri dhe fëmijë. (Isra, 64)

Shejtani dhe miqtë e tij

Shejtani ka miqtë e tij dhe ai i frikëson ata. (Ali Imran, 175) Shoqëria me shejtanin, gjithmonë e bën njeriun të humbë. (Nisa, 38, 119.) Shejtani i tërbon ata që e bëjnë mik atë. (A'raf, 202; Merjem, 83.) Miqtë e shejtanit u duan vetëm të keqen njerëzve. Për këtë arsye, duhet të kemi kujdes kundrejt tyre. (Nisa, 76) Shejtani dhe miqtë e tij, janë në luftë me ata që besojnë. (En'am, 121) Shejtani dhe miqtë e tij përfitojnë prej njëri-tjetrit dhe përpiqen natë e ditë që njerëzit të bien në ligësi. (En'am, 128) Shejtanët janë miqtë e atyre që nuk besojnë. (A'raf, 27) Politeistët nuk i luten Allahut Teala, por idhujve dhe shejtanit. (Nisa, 117) Shejtani dhe pasuesit e tij i shikojnë njerëzit nga një vend prej ku njerëzit nuk mund të shohin. (A'raf, 27) Ata që bëjnë mik shejtanin, nuk janë në rrugë të udhëzimit. (A'raf, 30) Pasuesit e shejtanit do të futen në xhehenem në gjendje të gjunjëzuar. (Merjem, 68) Shejtani i zvarrit në ndëshkimin e zjarrit flakërues bashkudhëtarët e tij. (A'raf, 18; Haxhxh, 4; Lukman, 21; Shura, 94-95.) Miqtë e shejtanit do të pendohen për shkak të miqësisë që kanë pasur me atë dhe do të thonë: "Ah sikur të ishim larg prej teje aq sa është larg lindja nga perëndimi!" (Zuhruf, 38) Shejtani ka shumë pasues. (Sebe', 20)

Kurthi i shejtanit është i dobët

Shejtani thur kurthe dhe dredhi, por kurthet që thur ai janë të dobëta. (Nisa, 76)

Fjalëve të shejtanit nuk u besohet

Shejtani u jep fjalën njerëzve, u premton, madje u betohet atyre në mënyrë që t'i gënjejë, por të gjitha këto janë thjesht mashtrime. (Nisa, 120; Isra, 64.)

Punët e shejtanit

Alkooli, bixhozi, idhujt, falli dhe shigjetat e fatit janë punët e shejtanit. (Maide, 90) Shejtani dëshiron të fusë armiqësi e urrejtje ndërmjet njerëzve me anë të alkoolit e bixhozit dhe t'i largojë ata nga dhikri e namazi. (Maide, 91)

Fuqia e shejtanit nuk i mposht dot të devotshmit

Shejtani nuk mund të sundojë vetëm mbi ata njerëz që besojnë dhe i mbështeten vetëm Zotit të Lartësuar. (Nahl, 99; Sebe', 21.) Shejtani nuk mund t'u bëjë asnjë lloj dëmi besimtarëve pa lejen e Allahut. (Muxhadele, 10) Edhe pse shejtani dëshiron t'i hutojë robërit e sinqertë, nuk ia del dot mbanë. (Hixhr, 40, 42; Sad, 82-83.)

Allahu e mbron shpalljen e tij nga devijimi i shejtanit

Allahu i Madhëruar i ka mbrojtur ajetet fisnike duke i shkatërruar sulmet e shejtanëve ndaj shpalljeve dhe profecive të pejgamberëve. (Haxhxh, 52) Qiejt janë të mbrojtur nga ndërhyrjet e shejtanëve. (Saffat, 7; Mulk, 5.)



Kubra Çoban

Nëse e kundërshton djallin, BESIMI FORCOHET

Punon natë e ditë pa u lodhur e pa u mërzitur. Nuk lodhet dhe nuk e humb shpresën qoftë edhe për një çast. E vazhdon rrugën e tij me këmbëngulje dhe vendosmëri. Aq sa përpiqet të kryejë në mënyrën më të mirë detyrën tij. Po ashtu, është edhe mendjemadh... Për kë po flasim? Për djallin...

Kur vendosim të bëjmë një punë të mirë, menjëherë na pëshpërit në vesh e na thotë:

"A nuk ka njeri tjetër që ta bëjë këtë punë, lëre fare, rri rehat!.."

Kur këndohet ezani dhe bëhesh gati të falësh namazin, të thotë:

"Ka kohë; qetësohu edhe pak, e fal më vonë..." Por nuk mjafton me kaq, vazhdon të të bëjë vesvese:

"Bëje edhe këtë punë, edhe kjo është e rëndësishme, shko edhe atje, pastaj e fal..."

Lufton deri në fund. Edhe nëse me gjithë pengesat e tij e fal namazin në çastin e fundit duke u privuar nga sevapi i tij, kjo e ngushëllon atë. Ai mundohet të bëjë çdo gjë, edhe pse mund të arrijë pak, por më e mira do të ishte të mos e kishe falur...

Të mashtron me mëshirën e Allahut duke thënë:

"Allahu është i madh, të fal!.."

Nëse kundrejt çdo gjëje je lidhur në namaz, të pëshpërit gjëra që nuk mund t'i paramendosh dhe të pengon të ndjesh kënaqësinë e namazit. Përpiqet me këmbëngulje që t'i çojë dëm të gjithë adhurimet dhe veprat e tua të mira. Në problemin më të vogël të thotë:

"Shiko, Zoti nuk të do. Po të të donte, nuk do t'i kishe përjetuar këto!.."

Sa më shumë që t'i i afrohesh Allahut, aq më shumë mundohet edhe djalli të të kthejë nga ajo rrugë... Ai edhe në frymën e fundit ta kërkon besimin për një gllënjkë ujë.

Por djalli nuk ka forcë trysnie mbi robërit. Ai vetëm pëshpërit dhe këshillon. Ai nuk detyron, nuk mund të detyrojë. Allahu Teala në ajetin 175 të sures Al Imran thotë:

"Vetëm djalli i frikëson ithtarët e vet. Ju mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!"

Besimtari i vërtetë zotëron një besim të përsosur. Është ai që i frikësohet vetëm Allahut dhe dëgjon vetëm zërin e Tij. Djalli nuk mund t'i bëjë asgjë atij që e ka besimin të fortë!.. Sepse Allahu Teala thotë në Kuranin Famëlartë:

"...Ne i kemi bërë djajtë roje të atyre që nuk besojnë." (Araf, 27)

Nëse shpejtojmë dhe jemi këmbëngulës në vepra të mira, si për shembull: sa të bëhet ezani, ta falim menjëherë namazin, të hapim sytë në mes të natës për të falur namazin e tehexhxhudit dhe të mos dëgjojmë zërin e Iblisit që na thotë "fli edhe pak", në këtë rast e kemi kundërshtuar Shejtanin. Kur personi e lodh nefsin, i forcohet shpirti, kur e kundërshton djallin, i forcohet besimi. Ai që nuk e kundërshton djallin, Allahu na ruajtë, kundërshton Allahun.

Nëse ndikohemi nga pëshpëritjet e djallit dhe shkojmë sado pak në rrugën e tij, duhet patjetër t'i analizojmë pikat tona të dobëta. Krijuesi gjithmonë e udhëzon robin e Tij në të mirë e në të drejtë, ndërsa djalli i pëshpërit të ligën dhe të gabuarën. Nga cila anë të anojë zemra jonë, atë zë dëgjon më shumë. Ai që e ka të fortë besimin, patjetër që ia vë veshin zërit të Allahut të Madhëruar.

Allahu Teala e shpjegon shumë herë në Kuranin Famëlartë gjendjen e atyre që bien pre e nefsit dhe dëgjojnë zërin e shejtanit. Ja njëra prej tyre:

"Djalli ua zbukuroi atyre veprat e këqija dhe u tha: "Askush në botë nuk do t'ju mundë sot dhe unë jam mbrojtësi juaj". Mirëpo, kur u ndeshën dy ushtritë *(me engjëjt përkrah besimtarëve)**, ai u kthye nga thembrat e tij dhe u tha*** *(jobesimtarëve)**: "Unë nuk kam të bëj me ju; unë shoh atë që ju nuk e shihni dhe i frikësohem Allahut, sepse Allahu ndëshkon ashpër"*** (Enfal, 48)

Do të thotë se duhet ta zgjedhim mirë mikun dhe armikun. Ndonjëherë përreth nesh ka djaj me pamje miqsh, të cilët na bëhen pengesë për çdo vepër të mirë. Ndonjëherë, edhe pse miqësia me ta na duket problematike, kemi miq të cilët na inkurajojnë në vepra të mira. Prandaj cilin prej tyre të dëgjojmë, ai zë na vjen më i afërt dhe më i dashur.

Allahu na ruajtë nga dëmi i miqve djaj me pamje njeriu. Na e forcoftë besimin aq sa të mos ia vëmë veshin pëshpëritjes së shejtanit! Amin!

Djalli dhe sulmet e tij

Tuba Çënar

Pasi Allahu Teala i fryu shpirtit të Ademit, (a.s.), i urdhëroi engjëjt që t'i bënin sexhde. Në atë kohë mes xhindëve, të cilët u komunikuan për këtë urdhër, ishte edhe Iblisi. Edhe pse të gjithë engjëjt i bënë sexhde, Iblisi nuk i bëri. Ngaqë e kundërshtoi urdhrin e Allahut Teala, u dëbua nga xheneti e nga vendi i mirësive të pafundme dhe u mallkua. Ndërsa ai i kërkoi kohë dhe leje Allahut Teala që deri në Kiamet t'i zvarrisë në devijim Ademin dhe pasardhësit e tij. Si nevojë për sprovën Allahu Teala ia dha këtë leje djallit.

Që atë ditë djalli mundohet në rrugë dhe mashtrime të ndryshme ta nxjerrë njeriun nga rruga e udhëzimit. Deri sa njerëzit të japin frymën e fundit, djalli nuk u ndahet dhe nuk e humb shpresën.

Djalli dhe ushtria e tij së pari mundohet ta çojë njeriun në devijim dhe mohim. Nëse ia arrin kësaj, mundohet për të rritur gradën e mohimit dhe thellësinë e batakut të mëkatit. Nëse edhe kësaj ia del, largohet prej tij "Duke u druajtur nga thellësia e mohimit të njeriut dhe mostrembja e tij në rebelim". Pothuajse thotë: "Ti ma kalove edhe mua; unë kam frikë Allahun e nuk mund të bëhem kaq i lig!"

Nëse nuk mund ta çojë njeriun në devijim, mohim dhe rebelim, mundohet të fusë dyshime në besimin e tij dhe vesvese në veprat e tij. Mundohet ta mbajë larg nga punët e devotshme, veprat e mira, adhurimet dhe miqtë e mirë.

Nëse edhe këtë nuk mund ta arrijë, mundohet t'ia krimbë adhurimet dhe shërbimet fetare. Ai i vendos mburrje, mendjemadhësi, egoizëm e krenari në zemër duke i thënë: "Sa njeri i madh që je! Sa punë të mëdha që ke bërë!.." E bën ta shohë veten të madh, ndërsa të tjerët të vegjël. Nëse edhe këtë nuk e arrin dot, e bën të përgojojë dhe të flasë për të tjerët.

Duke shfrytëzuar çdo rast mundohet të hyjë në zemrën e atij njeriu. Nganjëherë mundohet ta bëjë njeriun që t'i lërë adhurimet, t'i neglizhojë ose t'i kryejë me mangësi, duke i dalë atij përpara me petkun e nënës, fëmijëve, bashkëshortit-es apo mikut të tij.

Nëse robi e mbron sinqeritetin dhe devotshmërinë ashtu siç mbron besimin, djalli ngel i dobët. Tashmë tërhiqet nga ai person dhe fillon të kërkojë dyer të tjera. Por në fakt atë nuk e braktis plotësisht. Ai pothuajse qëndron në pritë dhe shfrytëzon çdo rast për ta devijuar atë.

Sulmin e fundit djalli e shfaq në çastin kur njeriut i mbyllet perdja e jetës së kësaj bote. E kontrollon për herë të fundit njeriun të cilin nuk ka mundur ta mposhtë deri në atë çast. Në frymën e fundit ku njeriu përpëlitet nga zjarrmia, djalli i premton një gotë ujë të ëmbël në këmbim të besimit të tij. Nëse në atë çast robit i dobësohet besimi, e shet frytin e të gjithë jetës për asgjë.

Allahu Teala na ruajtë të gjithëve nga ky fund i lig. Na dhëntë maturi dhe vetëdije kundrejt djallit dhe mashtrimeve, lojërave e vesveseve të pafundme të tij. Na bëftë prej njerëzve të sinqertë, të cilët i mbron nga ligësitë e djallit! Amin!

Aishe Gënyl Bejaz

Respekti ndaj xhumasë dhe as'habu's-sebt

Në ajetin 9-10 të sures Xhuma, thuhet kështu:

"O ju që keni besuar! Kur të thirreni për** (të falur) **namazin** (e xhumasë) **në ditën e premte, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë! Kjo, që ta dini, është më mirë për ju! Dhe, kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, kërkoni nga mirësitë e Allahut dhe përmendeni shumë Allahun, në mënyrë që të shpëtoni."

Që ditën e parë kur kam lexuar këto ajete fisnike, më rrethoi mendimi se respekti ndaj xhumasë, është respekt ndaj Allahut Teala... Domethënë, kur të thirret ezani, duhet të ndalojë tregtia dhe jeta. Në këtë mënyrë, të gjithë duhet të nxitojnë për në namaz dhe përkujtim të përbashkët të Allahut (xh.xh.).

Pastaj u ktheva dhe pashë mënyrën e jetës sonë. Pashë dyqanet që nuk mbyllen kur thirret ezani, pashë se burrat i linin gratë në dyqan në mënyrë që ky i fundit të ngelej hapur kur burrat shkonin në namaz dhe gratë që dalin për të blerë dyqan më dyqan sikur prisnin atë kohë.

Kur po shëtisja në atmosferën e Kuranit Fisnik, u takova me një ndodhi të ngjashme me këtë. Allahu i Madhëruar ua kishte ndaluar gjuetinë bijve të Izraelit ditën e shtunë. Kurani Fisnik i quan ata "As'habu's-Sebt", domethënë, njerëzit e ditës së shtunë... Këta ishin një popull rreth shtatëdhjetë mijë vetë që jetonin ndërmjet Egjiptit dhe Medjenit. Ditën e shtunë ky popull e kishte haram punën përveç ibadetit. Ashtu siç është ndaluar tregtia në kohën e Xhumasë në suren el-Xhumuah... Veçanërisht, ata i patën dhënë fjalën Davutit, alejhisselam, për të mos gjuajtur. Por më vonë shejtani u bëri vesvese dhe u tha:

"Juve nuk ju është ndaluar gjuetia, por të ngrënët."

Si sprovë nga Zoti, ditëve të shtuna, peshqit shtoheshin. Ndërsa ditëve të tjera, pakësoheshin. Populli i Medjenit u nda tre grupesh në këtë çështje.

Një pjesë prej tyre i hidhnin rrjetat ditën e xhuma dhe i mblidhnin ato ditën e dielë. Në pamjen e jashtme dukej sikur ata nuk gjuanin ditën e shtunë dhe pandehën se mashtruan Allahun Teala.

Një pjesë tjetër nuk thoshin asgjë kundrejt tyre, edhe pse e pranonin se zgjidhja që po praktikonin ata nuk është e drejtë dhe e neglizhuan këtë situatë. Ndërsa grupi i fundit i paralajmëronte njerëzit se po shkonin në rrugë të gabuar.

Ata që zgjodhën heshtjen, në të njëjtën kohë përpiqeshin t'i heshtnin edhe ata që këshillonin popullin duke u thënë:

"Përse këshilloni një popull që do të shkatërrohet? Po lodhni veten tuaj kot..."

Ndërsa ata që po përpiqeshin për të urdhëruar të mirën dhe për të ndaluar nga e keqja, u përgjigjën:

"Ne po i paralajmërojmë ata për të mos mbajtur përgjegjësi para Allahut Teala dhe që të mos merremi në llogari për fajin që kanë bërë ata."

Sipas transmetimeve të tefsireve, ata që u përpoqën ta thyenin ndalesën e ditës së shtunë, u kthyen në majmunë si ndëshkim nga Allahu i Madhëruar. Tre ditë ecën në këtë formë dhe pastaj vdiqën. Edhe ata që heshtën dhe vazhduan jetën e tyre, i gjeti e njëjta gjë. Ata që shpëtuan prej këtij populli, ishte vetëm grupi i tretë që "urdhëroi për të mirë dhe ndaloi nga e keqja."

Ata që kërkonin mënyrat për të thyer ndalesën e Allahu Teala dhe ata që nuk ndërhynë e u tërhoqën, merituan ndëshkimin hyjnor...

Kurani Fisnik nuk është një libër historie. Pra, nuk është një libër i zbritur për të kaluarit apo një libër që tregon vetëm jetët e tyre. Edhe ne si myslimanë të sotëm duhet të nxjerrim shumë mësim nga kjo histori. Falja e namazit të xhumasë është farz... Burrat duhet ta respektojnë dhe zbatojnë këtë... Por ndërprerja e tregtisë, në të njëjtën kohë është detyrë edhe e grave. Çfarë mund të ndodhë sikur tregtinë ta bëjmë gjysmë ore para apo gjysmë ore mbrapa?

Allahu është furnizuesi më i mirë... Edhe neve na furnizoftë me risk prej hallallit.

Allahu i Madhëruar na mundësoftë që të marrim mësim nga historitë e Kuranit Fisnik dhe na dhëntë mundësinë për t'i mbartur në ditët e sotme. Amin!

Halime Demireshik

Nëse ti nuk je më e bukur se hëna, divorcohu!..

Dijetarët e sarajit po debatonin për emrin e vajzës së vogël e të mrekullueshme, e cila ia kishte ngulur sytë tavanit të artë dhe po mundohej ta shikonte. Ndërkohë që ata po flisnin të ngazëllyer, hyri brenda Halifja i dytë i Abbasive, Xhafer Ebu Mensur. Dijetarët u përulën me delikatesë përballë tij dhe heshtën. Halifeja Xhafer Ebu Mensur e përqafoi mbesën e tij jo si një halife, por me ngrohtësinë e një gjyshi... Bukuria e saj të magjepste...

Ai u lut për mbesën e tij duke thënë:

"Paç fatin ashtu siç ke edhe bukurinë! Të qofshin të pranuara si gjendja ashtu edhe veprat e tua të mira!..

Pastaj, duke i thënë "Allahu të bëftë një xhevahir të zgjedhur në çdo mirësi! Emrin e paç Zubejde!..", i pëshpëriti në vesh ezanin, ikametin dhe emrin i cili do të thotë e zgjedhur, thelbësore, xhevahir...

Na saraj Zubejdeja mori dijen më të mirë, mësoi edukatën dhe delikatesën... Me çdo gjendje të saj, sidomos me moralin për të cilin shquhej, me bukurinë e saj ndriçonte si një diell gjithë vendin përreth. Dinte t'i bënte për vete të gjithë njerëzit, nga më i rëndomti deri te më i veçanti... Fisnikëria e cila bashkohej me prejardhjen e Pejgamberit (s.a.s.) dhe morali i saj i lartë ia shtonin edhe më bukurinë asaj.

Shërbëtoret e sarajit garonin për t'i shërbyer asaj. Aq ëmbël u drejtohej shërbëtoreve, sikur t'i kishte motra. Të gjitha i vinin rrotull si flutura për të marrë një kompliment nga ajo.

Në kohën e vajzërisë emri i saj përmendej gjithmonë për mirë. Ajo ishte shpëtimtarja e familjeve që kishin probleme dhe dera referuese e të rinjve të cilët nuk mund të martoheshin për shkak të varfërisë.

Një ditë shërbëtoret po bisedonin në kuzhinë. Ajo që po lante enët tha:

"A nuk bëhet pak mendjemadh njeriu në gjithë këtë pasuri dhe bollëk?"

Tjetra tha:

"Ta kisha unë këtë bukuri, do t'i bëja të gjitha gratë të plasnin nga xhelozia..."

"Zonja jonë sikur është një engjëll i zbritur nga qielli..."

Fjalët e tyre i dëgjoi edhe Harun Reshidi, i cili po kalonte andej dhe që nuk i kishte mbushur akoma të pesëmbëdhjetat.

Ndërkohë që mendoi "Domethënë kjo Zubejdeja qenka si një engjëll pa krahë", flladi i ngrohtë që i fryu në zemër, e bëri të turpërohej.

Kaluan dy vjet, por Harun Reshidi akoma e kishte mendjen te Zubejdeja. Çfarë dhe si duhej t'ia bënte që t'ia transmetonte këto ndjenja Zubejdes? Nuk gjeti dot asnjë rrugë. Po sikur Zubejdeja të mos e pëlqente atë? Po sikur t'ia refuzonte propozimin, çfarë do bënte?

Ndërsa po përpëlitej me këtë shqetësim, doli në kopshtin e sarajit. Papritur përballë tij u shfaq Behlul Dana. Behluli ishte i afërm dhe shoku i tij më i ngushtë. Pothuajse një thesar.

"Çfarë të ka ndodhur Harun? Sikur të gjitha hallet e botës i ke mbi shpinë dhe po të shtypin!" i tha duke bërë shaka.

"Skam gjë", i tha Harun Reshidi...

Behluli i tha duke buzëqeshur:

"Poshtë çdo "asgjëje" ndodhet një sekret. Kjo e jotja duket si hall zemre, dhimbje dashurie..."

Haruni u turpërua aq shumë, saqë iu skuqën veshët nga turpi. Ai tundi kokën sikur donte të thoshte "Po". Bisedoi gjerë e gjatë me Behlul Danën dhe i tregoi atij për dashurinë të cilën kishte ushqyer që në fëmijëri dhe tashmë e mbante në zemër... E tregoi dhe u lehtësua, u qetësua.



Me iniciativën e Behlul Danës në një kohë të shkurtër u bë martesa... Në fakt të gjithë e kishin parë të përshtatshëm bashkimin e dy të rinjve...

Ceremonia e dasmës zgjati dyzet ditë e dyzet net... Ndërsa paja dhe qerasjet pothuajse u përmendën dyzet vjet.

Harun Reshidi i kapi dorën bashkëshortes së tij, fytyra e së cilës ishte mbuluar me mëndafsh dhe që kundërmonte erë misku, pastaj filloi fjalën e tij me një zë të dridhur dhe të emocionuar:

"Zubejde... Bukuria turpërohet prej teje dhe është thjesht një hije përballë bukurisë tënde Zubejde... Morali, edukata, dija dhe fisnikëria të janë mbledhur me plot kuptim në zemër Zubejde... Sulltanesha ime e dashur, e zgjedhura e sarajit, nëna e mirësive... Mirë se erdhe në shtëpinë tënde! Mirë se erdhe në zemrën time! Sa mirë që erdhe!.. Qëndro gjithmonë këtu, në shpirtin tim! Mos më lër kurrë vetëm në burgun e kësaj bote!.."

Ndërkohë që fliste Harunit i djersinin duart dhe i ishin tharë buzët nga emocioni. Duart e tij i ishin djersitur edhe duart e Zubejdes, e cila nuk foli aspak. Ajo tha duke i zgjedhur fjalët:

"Kam frikë sulltani im se nuk do të jemi të lumtur dhe nuk do të kuptohemi me njëri-tjetrin!.."

Harun Reshidi i tha:

"Sulltanesha e fronit të zemrës sime!.. Lumturia nuk do të thotë që të dy personat të jenë pa mangësi; ajo bëhet kur të dy i tolerojnë mangësitë e njëri-tjetrit. Ta tolerojmë njëri-tjetrin, që të jemi të lumtur!.."

Ai e hapi kapakun e sëndukut që kishte pranë. Pak më parë këtë sënduk e mbajtën dhe e sollën dymbëdhjetë shërbëtorë. Zubejdeja po e shikonte me kureshtje. Sënduku ishte i mbushur plot me flori, perla, diamante dhe lloj-lloj bizhuterish të tjera.

Kjo është dhurata e nusërisë!.. Vlera jote nuk matet me asgjë, por kjo është diçka modeste e kësaj bote. Allahu të dhëntë stolinë e vërtetë që është kënaqësia e Tij!.."

Zubejdeja i tha:

"Më shumë se florinjtë më pëlqeu lutja jote. Dhurata e vërtetë për mua është lutja jote e çmuar."

Mëngjesin e parë të martesës Zubejdeja priti të parët të varfrit, të cilët kishin ardhur për ta uruar... Në fakt askush nuk u habit për këtë, sepse kjo ishte në natyrën e Zubejdes...Të varfrit i dhuronin asaj lutje... Ndërsa Zubejdeja zhyste dorën në sëndukun ku ndodhej dhurata e saj e nusërisë dhe ua mbushte duart të varfërve me çfarëdo që kapte; flori, argjend e shumë të tjera. Të varfrit, të përlotur, luteshin me më shumë përzemërsi për të.

Kur robëreshat e sarajit i thoshin:

"Mos e bëni këtë sulltaneshë, mos i mësoni kështu!.. Lërini, ju jep Allahu atyre...", sulltanesha Zubejde u thoshte:

"Allahu më ka dhënë mua që t'u jap atyre. Në fakt nuk jam unë që jap!"

Lumturia e martesës po shtohej dita ditës. Harun Reshidi, si sulltan që ishte, mund të martohej edhe me gra të tjera, por nuk e bëri. Gruaja e tij e vetme ishte sulltanesha Zubejde.

Zubejdeja një natë para se të flinte filloi të krihte flokët me krehër argjendi pranë Harun Reshidit. Haruni

po e ndiqte me admirim. Një dritë hëne shkëlqeu mbi të nga dritarja. Kjo rreze ndriçuese ia shtoi edhe më shumë bukurinë asaj. Edhe ajo madje u admirua nga bukuria e saj. Iu afrua burrit të saj Harun Reshidit, ia mori dorën, e puthi dhe i tha:

"Pa më thuaj kush është më e bukur, hëna apo unë?"

Haruni në fillim nuk u përgjigj, sepse nuk gjeti fjalë për ta përshkruar. Zubejdeja e përsëriti e ngazëllyer tri herë pyetjen. Pastaj Harun Reshidi i tha:

"Nëse ti nuk je më e bukur se hëna, divorcohu nga unë (tri herë)!"

Nga kjo fjalë e Harun Reshidit nuk nënkuptohej divorci me Zubejden. Aq sa ishte i pamundur divorci me Zubejden, aq ishte e pamundur që hëna të ishte më e bukur se ajo. Por nga ndikimi i fjalës që u tha, asnjëri nuk foli për një kohë.
I shtrënguan fort duart.



Harun Reshidi të nesërmen u kthye në dhomë i shqetësuar se mos me fjalën që kishte thënë në mbrëmje kishte bërë një gabim të madh. Në fakt, as martesa, as divorci nuk ishin shaka. Hëna ishte një krijesë mbi të cilën edhe Allahu Teala ishte betuar në Kuranin Famëlartë. Po sikur ajo të ishte më e bukur se Zubejdeja... Atëherë çfarë do të bënte?

Menjëherë mblodhi dijetarët dhe i pyeti:

"Cila ka më shumë epërsi, hëna apo njeriu?"

Ndërkohë që debati zgjaste, nuk po gjenin një përgjigje. Në atë kohë hyri brenda Hazreti Behlul Dana. Ai tha:

"Çfarë po bëni? A ka ndonjë ceremoni hatmeje? Çfarë ka ndodhur? Meqë paska kaq shumë pjesëmarrës, të lexoj edhe unë rreth dhjetë ajete fisnike" Pastaj filloi të lexonte me frikërespekt suren Tin. Kur arriti te ajeti:

"Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur.", Harun Reshidi u drejtua i gëzuar dhe bëri sexhde falënderimi ndaj Allahut Teala, për shkak se e nxori me selamet nga ky problem. Pastaj tha:

"O Zot, kjo me të vërtetë është mirësia Jote... Gruaja ime e dashur në zemrën time është më e bukur se hëna në qiell."

Dijetarët që u kthyen atë kohë nga haxhi, erdhën te sulltani për të marrë uratën e tij. Ndërkohë që flisnin për kujtimet e haxhit, treguan se si haxhinjtë vuajtën shumë për ujë në Mekë. Zubejdes i lindi në zemër që të çonte ujë të ftohtë në ato toka të bekuara. U ngrit, fali dy rekatë. Iu lut Krijuesit që t'i hapte dyert e mirësisë.

Bëri konsultime dhe më në fund, duke përdorur pasurinë e saj personale, bleu ujin e ëmbël i cili buronte mes Taifit dhe Hunejnit. Për ta dërguar këtë ujë te haxhinjtë e Arafatit, bleu të gjitha kopshtet me hurma që ndodheshin në atë rrugë dhe e dërgoi ujin në Arafat. Për këtë vepër të mirë harxhoi 1.700.000 miskal (masë prej 4.5 gr) florinj. Ishte shumë e lumtur, sepse tashmë do t'u ofronte të gjithë hanxhinjve në Arafat një ujë të pastër që ata të pinin e të freskonin shpirtin.

Zubejdeja jetoi shumë e lumtur. Ajo stolisi jetën me vepra të mira e mirësi. Asnjë zonjë në kohën e saj nuk mundi ta konkurronte në vepra të mira.

Pas vdekjes së saj, të varfrit dhe të mjerët mbajtën zi. Ajo u kujtua për muaj me radhë duke iu kënduar hatme...

Pas migrimit të saj nga kjo botë, shërbëtorja e pa në ëndërr ku i tha:

"Sulltaneshë, kaq shumë vepra të mira që ke bërë në këtë botë, kushedi se ç'pozitë të lartë të ka dhënë Allahu Teala në xhenet?"

Sulltanesha Zubejde iu përgjigj:

"Po, është e vërtetë... Zoti i Gjithëmëshirshëm me të vërtetë më dhuroi një pozitë të lartë në xhenet, por këtë pozitë nuk ma dha për shkak të këtyre bamirësive. Një ditë në kuvendin ku ndodhesha po këndoheshin ilahi dhe po bëheshin lavdërime. Ndërkohë që muzikantët u binin veglave muzikore, dëgjova nga minaret e xhamive të këndohej ezani. Menjëherë thashë: "Pushoni, të dëgjojmë ezanin!" dhe të gjithë heshtën. Ja, në çastin e marrjes në pyetje të gjitha veprat e mia rrodhën e u derdhën. Mes tyre ishte edhe ndërtimi i kanaleve ujore deri në Arafat. Por mua m'u tha: "Të falëm vetëm nga respekti që tregove kundrejt ezanit!.."

Shumë vite pas vdekjes së saj, kur një i varfër nga Bagdadi, i cili kishte shkuar në haxh dëgjoi një banor që thërriste nëpër rrugë:

"Është uji i zonjës Zubejde, ujë shumë i ëmbël, shërim për shpirtrat.", nuk e mbajti dot veten dhe duke qarë u lut për këtë zonjë të bekuar së cilës akoma nuk i është mbyllur libri i veprave të mira:

"O sulltanesha ime që je vetë e pasur dhe zemrën e ke të pasur... A edhe këtu i freskon të varfrit?!"

Osman Nuri Topbash

Mbretëria e modestisë

Gazneli Mahmudi kishte dëgjuar për famën e të nderuarit Ebu'l-Hasan Harakanit dhe një ditë, së bashku me njerëzit e tij, shkon për ta vizituar në Harakan. Qëllimi në zemrën e sulltanit, nuk ishte të përfitonte shpirtërisht duke vizituar një të dashur të Allahut, por ta sprovonte atë me pyetjet që do t'i bënte.

Mirëpo, me ndihmën e Allahut, Ebu'l Hasan Harakani, e ndjeu qëllimin e keq që fshihte sulltani në zemër dhe deshi t'i tregonte sulltanit se me mendjemadhësinë e tij nuk mund të arrinte majat më të larta dhe se virtyti i vetëm që e nderon një sulltan, është modestia. Prandaj, kur sulltani erdhi pranë tij, ai nuk tregoi ndonjë interes të veçantë për të, madje nuk u ngrit as në këmbë.

Gazneli Mahmudi i cili nuk arriti ta kuptonte të fshehtën e pritjes që i bëri Ebu'l Hasani, filloi t'i drejtonte atij një nga një të gjitha pyetjet që kishte përgatitur. Por për shkak të përgjigjeve të kënaqshme që mori dhe përballë urtësisë së shehut, sulltani u tërhoq. Shpirti i tij, i cili në fillim ishte turbulluar me qëllimin për të sprovuar një të dashur të Allahut, në fund kaplohet nga një paqe dhe qetësi e papërshkrueshme dhe mbushet me dashuri dhe respekt ndaj shehut.

Në shenjë të dashurisë dhe respektit që i mbushi zemrën, sulltani deshi t'i japë shehut një qese me flori, por Ebu'l Hasani e refuzoi me mirësjellje. Atëherë, sulltani i kërkon shehut ndonjë prej sendeve të tij, që ta mbante si kujtim. Këtë herë, Ebu'l Hasani nuk ia prishi qejfin sulltanit dhe i dha si kujtim këmishën e vet. Më në fund, takimi mbaron dhe, kur Gazneli Mahmudi po bëhej gati të ndahej, Ebu'l Hasani ngrihet në këmbë dhe e përcjell. Sulltani, sapo e pa që shehu u ngrit në këmbë për ta përcjellë, nuk e fshehu dot kureshtjen dhe e pyeti:

"Sheh i nderuar! Kur erdhëm, nuk u çuat në këmbë, por tani që po ikim, po na përcillni në këmbë. A mund ta di shkakun?"

Ebu'l Hasan Harakani, i përgjigjet duke thënë:

"Kur erdhët, në zemrën tuaj kishte krenari padishahu, ndërsa qëllimi juaj ishte të na sprovonit. Por tani, po ndaheni prej këtu duke qenë modest. Dhe ndaj modestisë kërkohet respekt." (Attar, Tezkiretu'l-Evliya, II, 209)

Modestia është virtyti më i mirë që i ka hije robit në jetën e kësaj bote të përkohshme, ditët e të cilës konsumohen shumë shpejt, si pema që i lëshon një nga një gjethet e saj në stinën e vjeshtës. Në një ajet fisnik, Allahut Teala urdhëron:

"Robërit e të Gjithmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: "Paqe qoftë!" (el-Furkan, 63)

Kur një rob tregon modesti për hir të Allahut, Allahu Teala ia shton urtësinë dhe e ngre atë në grada të larta. Por kush nuk i kupton të metat e tij, nuk pranon padituriné e tij dhe më e rëndësishmja, nuk pranon se është një "hiç" përballë fuqisë së pakufishme të Allahut Teala, vetëm sa pandeh se ka ndonjë vlerë apo fuqi. Ai që e pëlqen veten duke u mashtruar me këto pandehje, nuk mund të ketë asnjë grimcë prej virtytit të modestisë.

Duke vepruar kështu, ai njeri guxon ta quajë veten ortak në atributin "el-Kibrija / i Madhërishëm" të Allahut Teala. Mirëpo, ortakëria në atributin "el-Kibrija" nuk mund të falet kurrë, sepse edhe iblisi, duke treguar mendjemadhësi, tha "unë" dhe u shkatërrua. Edhe njeriu që zotëronte shumë virtyte, Bel'am bin Baura, ra në një gjendje të ulët për shkak të egos së tij. Ndërsa Karuni, duke ia atribuar vetes së tij mirësitë që i fali Allahu Teala, tha "i fitova vetë". Por edhe ai u varros së bashku me pasurinë e tij, tek e cila mbështetej aq shumë.

Profeti ynë (a.s.), në lidhje me urdhrin e Allahut në çështjen e modestisë, thotë:

"Allahu më ka njoftuar duke më thënë: "Bëhuni modestë! Askush të mos u mburret dhe t'u bëjë padrejtësi të tjerëve!" (Muslim, Xhennet, 64)

Modesti, do të thotë të jesh i përulur, ndërsa në një kuptim më të gjerë, të pranosh të vërtetën dhe t'i përulesh asaj. E vërteta duhet pranuar nga kushdo që të ketë ardhur, qoftë i madh apo i vogël, me pozitë të lartë apo të ulët në shoqëri. Ata që i dorëzohen në këtë mënyrë të vërtetës, janë njerëzit që zotërojnë modestinë e vërtetë.

Sipas njërit prej dijetarëve më të mëdhenj të brezit të Tabiinëve, Hasan Basriut, modest është ai njeri që, kur del nga shtëpia dhe ecën në rrugë, e konsideron më të lartë se veten çdo mysliman që takon. Edhe Fudajl bin Ijazi, që zotëronte të njëjtin botëkuptim, kur ishte duke bërë tavaf Qabenë, i thotë Shuajb bin Harbit që ishte një muhadith dhe besimtar i devotshëm:

"O Shuajb! Gabon rëndë, nëse pandeh se këtë vit me ty ka bërë haxh ndonjë tjetër më i keq se unë."

Modestia, e cila është edhe mirësia e vetme që nuk mund të kihet zili, është një virtyt shumë i rëndësishëm që e zbukuron njeriun, e bën më të pjekur dhe i jep formë moralit të tij. Mevlana i nderuar, e ka shprehur kështu:

"A gjelbëron një gur në stinën e pranverës? Bëhu modest si toka, që prej teje të dalin trëndafila dhe lule shumëngjyrëshe!.."

Gjallesat që shëtisin mbi tokë, e shkelin atë dhe të gjitha ndotësitë i hedhin aty. Mirëpo toka, me një modesti të jashtëzakonshme e pastron të gjithë këtë ndotësi dhe pastaj, duke nxjerrë bimë me bukuri të ndryshme, i ushqen të gjitha gjallesat që shëtisin mbi të. Ja pra, edhe shpirti i një besimtari të sinqertë, duhet të bëhet si një tokë pjellore. Të gjitha bukuritë e zemrës duhet t'i reflektojë tek njerëzit dhe madje tek të gjitha krijesat, si një poezi e natyrshme.

Sheh Sadi thotë se dikush që nuk sillet

me modesti dhe përulje si toka, "nuk është njeri". Sipas tij, ai që dëshiron të lartësohet, duhet të sillet me modesti dhe se për të dalë në majën më të lartë, nuk ka shkallë tjetër përveç përulësisë.

Nga kjo pikëpamje, modestia është një nga kushtet që njeriu duhet të plotësojë për të arritur nderin dhe respektin. Në lidhje me këtë, Ebu Bekri (r.a.), ka thënë:

"Bujarinë e gjetëm në devotshmëri, pasurinë në dituri dhe nderin në modesti."

Një ditë, kurejshët filluan të mburreshin me fisnikërinë e fisit të tyre. Sulejman Farisiu (r.a.), i cili po i dëgjonte, pasi heshti për pak kohë, me modesti të madhe iu drejtua atyre dhe u tha:

"Unë nuk kam me çfarë të mburrem, sepse unë jam krijuar prej nutfes[1] dhe në fund do të kthehem në një kufomë që mban erë të keqe. Më vonë, në ditën e gjykimit do të dal para peshores dhe, nëse sevapet e mia peshojnë rëndë, jam njeri i mirë, por, nëse peshojnë lehtë, jam njeri i keq."

Në një hadith fisnik, Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

"Allahu e ngre atë që është modest dhe i përulur për hir të Tij." (Muslim, Birr, 69)

I nderuari Bahauddin Nakshibendi, i cili bëri një jetë modeste dhe të thjeshtë, megjithëse ishte ngritur në grada të larta shpirtërore, për të shprehur ndjenjën e tij të të qenit "asgjë", thotë:

Bota është grur, kurse unë jam kashtë,

Bota është e mirë, kurse unë jam i keq!..

(Të gjithë janë në rregull, ndërsa unë me të meta)

Allahu Teala, si shpërblim për modestinë e tij, e ngriti dhe e bëri të dashur tek njerëzit. I dha një pozitë të lartë dhe e ngarkoi me detyrën e edukimit dhe udhëzimit të njerëzve.

Imam Gazaliu, në lidhje me pozitën e lartë në të cilën Allahu Teala i ngre ata që janë modestë, tregon këtë ndodhi:

Në kohën kur Allahu Teala po mbyste popullin e Nuhut me anë të tufanit, dallgët u frynë dhe u ngritën lart, por mali Xhudi u tregua modest. Kjo, sepse dallgët ishin të larta kurse mali Xhudi ishte më i ulët. Për shkak se mali Xhudi u tregua modest, Allahu Teala e shpërbleu, duke e vendosur anijen e Nuhut në majën e tij. (Ihja Ulumu'd-Din, III, 735)

Mirësitë e modestisë janë të shumta. Njeriu modest, është bujar. Njeriu bujar, është i mëshirshëm. Njeriu i mëshirshëm, është entuziast në shërbimin ndaj krijesave. Këto janë mënyrat më të mira për të fituar kënaqësinë e Allahut Teala.

Një ditë, Ibnu's-Semmak shkoi tek Harun Rashidi dhe i tha:

"O prijësi i besimtarëve! Modestia që tregon në këtë pozitë të lartë ku ndodhesh, të fal më shumë nder se sa gëzon."

Harun Rashidi tha:

"Sa bukur e the!"

Sammaku vazhdoi duke thënë:

"O prijësi i besimtarëve! Ai, të cilit Allahu Teala i jep bukuri, e bën pjesë të një familjeje fisnike dhe furnizon pa masë, e fsheh bukurinë, nuk mburret me të, dhuron prej

1. Për kuptimin e fjalës "nutfe" ka dy mendime: Disa thonë se është vetëm sperma, ndërsa disa të tjerë thonë se nufte është zigota që formohet nga bashkimi i qelizave të mashkullit dhe të femrës.

pasurisë së tij dhe nuk krenohet me familjen e tij fisnike, do të hyjë në mesin e robërve të sinqertë të Allahut."

Harun Rashidi, urdhëroi menjëherë që t'i sillnin një fletë dhe një penë dhe të gjitha këto i shkroi me dorën e vet.

Ai që është larg modestisë, nuk është gjë tjetër përveçse një njeri i mjerë, që i pëlqen vetja dhe zullumqar. Për shkak se e sheh veten më lart se të tjerët dhe nuk i nënshtrohet së vërtetës, ai patjetër që u bën padrejtësi atyre. Mirëpo, në sajë të mendjemadhësisë së tij, e hedh veten në një humbje të madhe.

Ata që largohen nga modestia dhe tregohen mendjemëdhenj si faraoni, asnjëherë nuk kanë shpëtuar nga poshtërimi në skenën e historisë. P.sh, kur Ebreheja erdhi me elefantët e tij të mëdhenj për të shkatërruar Qabenë, Allahu Teala nuk e shkatërroi me luanët, tigrat apo gjarpërinjtë e shkretëtirës, por me zogjtë që hodhën gurë të vegjël. Ndërsa atë (Ebrehenë), nuk e vrau para Mekes, por atje prej nga erdhi me mburrje dhe me krenari të madhe, në Jemen, në mes të popullit në një gjendje të plagosur dhe të poshtëruar. Edhe Nemrudin që e pandehte veten Zot, e shkatërroi me anë të një mize shumë të vogël. Ja pra, përfundimi i hidhur i atyre që hyjnë në garë me Allahun për madhështi dhe fuqi...



Allahu Teala, lumturinë e përjetshme ua dhuron atyre që në këtë botë nuk pretendojnë madhështi, nuk bëjnë të këqija, dhe atyre, zemrat e të cilëve janë të mbushura me dashuri për Allahun.

Është me vend që këtu të theksojmë edhe një fakt. Një besimtar duhet të sillet me modesti vetëm ndaj besimtarëve të sinqertë. Ndërsa njerëzve mendjemëdhenj, që u pëlqen vetja, që nuk pranojnë kritika, që i shohin të tjerët nga sipër dhe që sillen në mënyrë të padrejtë, nuk duhet t'u afrohen me modesti. Të tregosh modesti ndaj personave të tillë, që janë të dhënë pas dynjasë dhe që çdo gjë e matin me para dhe pozitë, do të thotë të sakrifikosh prej dinjitetit të Islamit. Dhe për këtë nuk ka të drejtë askush. Modesti nuk është të përulesh dhe të shtypesh përballë të padrejtit për shkak të një interesi. Modesti do të thotë të përulesh ndaj së vërtetës.

Allahu Teala, duke iu drejtuar Profetit tonë (a.s.), me këto fjalë:

"...Sillu butë me besimtarët!" (el-Hixhr, 88)

"Bëhu i butë me besimtarët që të pasojnë ty!" (esh-Shu'ara, 215) në të njëjtën kohë na urdhëron edhe ne që të sillemi me mëshirë dhe të jemi modestë.

Allahu Teala, të gjithë besimtarët i ka bërë vëllezër me njëri-tjetrin. Pastaj i ka urdhëruar ata që të interesohen për hallet e njëri-tjetrit, të bëhen ilaç për plagët e njëri-tjetrit dhe të lehtësojnë vështirësitë e vëllezërve të tyre. Prandaj, besimtarët duke mos harruar kurrë se janë vëllezër, të mos sillen keq ndaj njëri-tjetrit, të mos e shohin veten më lart se vëllezërit e tyre dhe, kur t'u bëhet ndonjë e keqe, të mos u kthejnë shpinën menjëherë, por të tregohen të kuptueshëm.

Ja Rabbi! Na bëj prej robërve të Tu të sinqertë që e jetojnë vëllazërinë islame në mënyrën më të bukur dhe që gjithmonë sillen me modesti... Amin!..



Mbulimi i avretit në namaz

Kevser Atar

Zakonisht, kur vështrojmë adhurimet, shikojmë se të gjitha kanë një kohë të caktuar. Për shembull, ndërsa agjërimi farz (i obliguar) është vetëm në muajin Ramazan, haxhi është vetëm një herë në jetë dhe në muajin Dhulhixhxhe. Zekati jepet nga të pasurit vetëm një herë në vit. Ndërsa kurbani pritet një herë çdo vit. Po namazi a është njëlloj?

Namazi është një farz që duhet të zbatohet pesë herë në ditë nga njeriu që ka arritur moshën... Jo një ditë, as një muaj, as një vit... Jo një herë gjatë gjithë jetës... Çdo ditë deri në vdekje; një urdhër që duhet të zbatohet pesë herë në ditë...Kjo gjendje padyshim është udhëzuesi më i madh për besimtarët e vërtetë në durim, në disiplinën e kohës, në pjekurinë e të gjitha ndjenjave dhe mendimeve materialo-shpirtërore dhe në rrugën që të shpie tek Allahu i Madhëruar... Shkurtimisht namazi është një lloj site që është bërë për të zgjedhur besimtarët e vërtetë...

Për të falur siç duhet namazin është shumë e rëndësishme të respektohen shtyllat dhe kushtet e tij... Por këto kushte të rëndësishme që duhet të mësohen nga njerëzit, shpeshherë nuk janë të njohura për ta, nuk përvetësohen ose nënvlerësohen... Njerëzit as që e kuptojnë se çfarë kanë humbur duke i lënë pa ditur këto dispozita...Sikur të mos i neglizhonin dispozitat e namazit, patjetër do ta vinin re këtë specifikë të rëndësishme:

"Siç dihet namazi ka plotë dymbëdhjetë farze. Këto farze mbartin pranueshmërinë e namazit. Por çështja që nuk dihet mjaftueshëm është e vërteta se lënia e njërit prej këtyre farzeve qoftë me vetëdije apo me harresë, bëhet shkak për prishjen e namazit..."

Çdokush nga ne mund të bëjë gabime të ndryshme ndërkohë që kryen adhurimet. E rëndësishme është që këto gabime të vihen re dhe të rregullohen. Përndryshe edhe koha dhe mundi për të falur namaz shkon dëm dhe nuk ka vlerë për asgjë.

Mangësia më e madhe gjatë faljes së namazit nga femrat është "setr-i avret: mbulimi i vendeve të turpshme". Për fat të keq mangësia në mbulim gjatë namazit te gratë shihet së tepërmi te personat që i dinë dispozitat. Për shembull, nëse i shohim gratë në jetën e përditshme kur shkojnë të falin namazin në xhami, do të vëmë re se shtatë nga dhjetë gra që falin namaz, mbajnë veshur çorape të holla të cilat tregojnë edhe ngjyrën e lëkurës dhe funde mbi kyçin e këmbës së tyre...

Madje mund të rastisni zonja që i kanë përveshur mangët e këmishës apo të pëlhurës deri mbi kyçe,

madje mund të rastisni edhe prej atyre që i kanë përveshur mangët e bluzës deri në bërryla!.. Por më shumë do të shikoni vajza të reja me shami të hollë që tregojnë flokët, veshët, zverkun dhe gjerdanët e tyre apo (prej atyre që kanë rënë në kurthin e njerëzve të cilët synojnë ta bëjnë shaminë e kokës një aksesor më shumë se një urdhër hyjnor), duke shfaqur flokët dhe trupin e tyre...

Së pari, gratë duhet t'i dinë shumë mirë rregullat në lidhje me "mbulimin e avretit" krahas të gjitha shtyllave dhe kushteve të namazit, sepse vendet e trupit që duhet të mbulojë gruaja në namaz, janë më të detajshme në raport me vendet që duhet të mbulojnë burrat. Ja disa pyetje-përgjigje në lidhje me mbulimin e grave në namaz:

Çfarë do të thotë, "mbulim i avretit" në namaz?

"Setr" është një fjalë arabe që do të thotë: Të mbulosh, të fshehësh dhe të fshihesh pas diçkaje. Ndërsa me termin "avret" sipas jurisprudencës islame duhet të kuptojmë pjesët e turpshme të trupit. Mbulimi i vendeve të avretit përgjatë namazit dhe jashtë tij, është një obligim fetar.

Cila është masa e mbulimit të avretit në namaz?

Masa e avretit të burrit në namaz: Pjesa ndërmjet kërthizës dhe gjunjëve. Në hadithin fisnik, thuhet:

"Mos e shiko kofshën e dikujt të vdekur apo të gjallë!.." (Ebu Davud, Xhenaiz, 28; Ibn Maxhe, Xhenaiz, 8.)

Fjala kofshë që kalon në hadith, synon pjesën e trupit nga kërthiza deri në gjunjë. Kjo masë fillon nga kërthiza dhe vazhdon deri poshtë gjunjëve, sepse në një hadith tjetër fisnik, thuhet: *"Gjunjët konsiderohen prej kofshëve."*

Mbulimi i pjesëve të tjera pas pjesës ndërmjet kërthizës dhe gjunjëve në namaz kur burrat falin namaz, është sunet. (Domethënë, të mbulosh krahët, pjesën e këmbëve poshtë gjunjëve, të vendosësh takije apo gjëra të tjera të ngjashme me të në kokë, të veshësh çorape...) Falja e namazit pa i mbuluar këto pjesë të trupit që janë sunet, është mekruh.

Ndërsa masat e avretit te gratë në namaz, janë ashtu siç përmenden në ajetin 31 të sures Nur:

"Thuaju besimtareve... të mos i shfaqin stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme..."

Nga shprehja ***"përveç atyre që janë të dukshme..."***, synohen duart, fytyra dhe këmbët (sipas Ebu Hanifes). Atëherë, vendi i avretit dhe stolitë, është i gjithë trupi përveç këtyre tri pjesëve. Madje është parë si diçka e virtytshme edhe mbulimi i këmbëve, për shkak se është një çështje e diskutueshme. Nisur nga kjo, është farz që në namaz apo jashtë tij (në praninë e burrave të huaj dhe në rrugë) gratë ta mbulojnë të gjithë trupin duke përfshirë flokët, qafën, gjerdanët, kyçet e krahëve dhe të këmbëve.

A prishet menjëherë namazi nëse përgjatë faljes së tij hapet ndonjë pjesë e trupit që duhet mbuluar?

Qoftë grua apo burrë, nëse hapet një e katërta e

një pjese që është farz për t'u mbuluar në namaz dhe nëse kjo pjesë e hapur vazhdon të mos mbyllet derisa të kryhet një shtyllë e namazit (domethënë, derisa të thuhet tre herë subhanallah), namazi prishet. Nëse kjo mangësi shikohet apo vihet re pas namazit, nuk e ndryshon rezultatin dhe namazi duhet të përsëritet. Por nëse është hapur më pak se një e katërta e një pjese të trupit që duhet mbuluar, namazi nuk prishet por është mekruh.

Nëse personi e shfaq me dëshirë një gjymtyrë që duhet të jetë e mbuluar në namaz, nuk është nevoja të kalojë koha e një shtylle, por namazi prishet në çast.

Çdo femër duhet të bëjë kujdes që mëngët e rrobës dhe fundi që vesh në namaz të jenë më të gjatë se normalja, sepse të gjithë e dimë se gjatë rukusë dhe sexhdes ato shkurtohen dhe bëhen shkak për dukjen e ndonjë gjymtyre. Prandaj duhet të kemi parasysh gjendjen e rrobës gjatë namazit.

A mund të falet namaz me rroba të tejdukshme?

Nëse rrobat janë aq të holla, sa dallohet ngjyra e lëkurës së trupit, ato nuk konsiderohen se i mbulojnë vendet e turpshme. Sa kohë që namazi falet me këto rroba, nuk kryhet namazi farz dhe kështu adhurimi nuk pranohet. Me rroba të tilla, ashtu siç nuk mund të falet namaz në dritë, nuk mund të falet as në errësirë. Sidomos shamitë e bardha e të tejdukshme që përdorin nënat dhe gjyshet tona në namaz, nuk i mbulojnë vendet e turpshme në namaz.

A mund të falet namaz me çorape të holla?

Për fat të keq në ditët e sotme mund të shohësh femra të mbuluara që kanë bërë normale veshjen e çorapeve të holla najloni dhe funde mbi kyçin e këmbës. Një veshje e tillë kurrë nuk mund të jetë mbulesa e një myslimaneje qoftë në rrugë apo në namaz. Një hadith fisnik lidhur me këtë çështje i këshillon gratë besimtare:

Sipas transmetimit të Ajshes (r.a.), motra e saj Esma erdhi një ditë te Pejgamberi, (a.s.), e veshur me një rrobë të hollë e transparente. I Dërguari i Allahut, (a.s.), e ktheu kokën mënjanë dhe tha:

"O Esma, kur një femër arrin moshën e pjekurisë, nuk duhet të tregojë pjesë tjetër të trupit përveç fytyrës dhe duarve." (Ebu Davud, Libas, 31.)

Gratë që veshin rroba të holla e transparente, duhet ta dinë mirë se:

Me veshje të tilla nuk e zbatojnë urdhrin e mbulesës dhe namazi i tyre nuk pranohet.

A është i pranueshëm namazi nëse falet me rroba që e mbulojnë komplet trupin, por që janë të ngushta?

Namazi që falet me rroba të ngushta, por që nuk e tregojnë ngjyrën e trupit, është i pranueshëm, sepse është e vështirë ta mënjanosh këtë. Namazi i falur me një veshje të tillë është mekruh.

Kur Pejgamberi, (a.s.), përmendi cilësitë e grave të xhehenemit, përdori shprehjen "e veshur, por e zhveshur". (Muslim, Libas, 125.) Dijetarët e Islamit kanë bërë të qartë se me këtë shprehje Pejgamberi, (a.s.), ka pasur për qëllim "gratë që veshin rroba të holla dhe të ngushta". Prandaj është më e vlefshme për personin që ai të zgjedhë rroba të bollshme për të falur namazin.

Një grua a mund të falë namaz me pantallona?

Nuk ka një veshje të veçantë për namazin. Rëndësi ka që namazi të falet me një veshje të pastër që nuk e tregon ngjyrën dhe linjat e trupit dhe që plotëson mbulesën.

Një zonjë që fal namaz me çdo lloj veshjeje që i përmban këto kushte, në namazin e saj nuk ka ndonjë problem nga aspekti i fesë. Ndërsa namazi i cili falet me pantallona që e bëjnë të qartë ndarjen e këmbëve, është mekruh. Nëse sipër këtyre pantallonave vishet një bluzë deri në gju, nuk do të thotë se s'është mekruh. Vetëm nëse vishet një rrobë e gjatë deri te kyçi i këmbëve apo ndonjë pardesy, namazi nuk është mekruh. Por është e domosdoshme që gratë të veshin rrobat e tyre dhe burrat rrobat e tyre.

Allahu na e mundësoftë të gjithëve të falim namaze të pranueshme. Amin!

Zahide Topçu

Mëshiroje jetimin

Allahu Teala, në shumë ajete të Kuranit fisnik shprehet se duhet të sillemi mirë kundrejt jetimëve dhe se duhet t'i ruajmë të drejtat e tyre. Për shembull, në një ajet të sures Bekare, thotë:

"Ne patëm marrë një premtim të tillë nga bijtë e Izraelit: "Nuk do të adhuroni askënd tjetër përveç Allahut dhe do të silleni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët dhe të varfrit..."

Nëse e shikojmë me kujdes radhën që shprehet në ajetin fisnik, pas adhurimit ndaj Allahut Teala, vjen mirësia ndaj prindërve dhe të afërmve dhe pastaj ndaj jetimëve...

Ndërsa në ajetet fisnike të sures Fexhr, thuhet:

"Jo, nuk është kështu! Por ju nuk silleni mirë me jetimët dhe nuk e nxitni njëri-tjetrin për t'i ushqyer të varfrit." (Fexhr, 17-18)

Ajeti fisnik është shumë i qartë. Allahu i Madhëruar ia ka vënë kusht njeriut që të sillet mirë ndaj të tjerëve dhe në veçanti ndaj jetimëve, në mënyrë që të arrijë ihsanin (gradën e lartë të adhurimit ndaj Allahut sikur e shikon Atë).

Në të njëjtën mënyrë, edhe në suren Duha këshillon që t'u themi fjalë të mira jetimëve dhe të sillemi mirë me ta:

"Prandaj mos e shtyp jetimin!" (Duha, 9)

Ngaqë edhe Pejgamberi, (a.s.), ishte rritur jetim, e kuptonte shumë mirë gjendjen e jetimëve. Në çdo rast i këshillonte sahabët e nderuar të silleshin mirë me jetimët dhe i ndaloi rreptësisht të nëpërkëmbnin të drejtat e tyre dhe të hanin pa të drejtë pasurinë e tyre.

Pejgamberi, (a.s.), i mësoi ata si të silleshin me jetimët duke i këshilluar:

"Bëhu një baba i mëshirshëm për jetimët!.." (Hejsemi, VII, 163.)

Edhe ai vetë i mbronte jetimët që kishte përreth, ua plotësonte nevojat dhe i respektonte ata si një mysafir në folenë e shpirtit të Tij.

Në një hadith fisnik Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

"Nëse dikush i ledhaton kokën një jetimi vetëm për hir të Allahut, i fshihen mëkatet sa numri i flokëve të atij jetimi." (Ahmed bin Hanbel, V, 250.)

Në një tjetër hadith fisnik ka thënë:

"Kush sillet mirë me jetimët për të cilët është përgjegjës, ai do të jetë me mua në xhenet kështu." Pastaj bashkoi gishtin tregues me gishtin e mesit. (Buhari, Edeb, 24, Talaj, 14.)

Njëherë erdhi dikush dhe i tha Pejgamberit (s.a.s.), se i ishte ngurtësuar zemra. Për këtë Pejgamberi, (a.s.), e këshilloi t'i ledhatonte kokën një jetimi, në mënyrë që t'i zbutej zemra. (Ahmed bin Hanbel, II, 263, 387.)

Kur të përdorim mallin e jetimëve në emër të tyre deri sa ata të rriten, duhet të veprojmë në mënyrën më të ndjeshme dhe duhet të mundohemi sa të mundemi që pasurinë e tyre të mos e përziejmë me tonën.

Enes bin Malik, radijallahu anhu, tregon:

Ne ishim pranë Pejgamberit, (a.s.), kur Ai ishte në çastet e vdekjes. Ai, në çështjen e namazit na tha tri herë: *"Kini frikë Allahun!.."*, pastaj shtoi:

"Kini frikë Allahun për njerëzit të cilët i keni nën mbikëqyrje. Kini frikë Allahun për dy njerëzit më të dobët; ata janë vejusha dhe jetimi." Pastaj filloi të përsëriste:

"Namazi, namazi!.." (Bejhaki, Shuab, VII, 477.)

Allahu Teala na bëftë ne nga ata besimtarë fatlumë që i gëzojnë jetimët dhe zënë vend në zemrën e Pejgamberit, (a.s.).

Amin!

Shefika Kaja Meriç

KLITHMA e fqinjit të uritur

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili ishte një njeri i vendosur dhe i ndershëm në të gjitha aspektet e jetës, e fton myslimanin që të jetë i ndjeshëm në të gjitha çështjet sociale dhe nuk e shikon të përshtatshme që të jetojë vetëm në planin individual. Edhe inzivanë (mbyllja në vetvete për të adhuruar Zotin, duke i ndërprerë të gjitha marrëdhëniet me njerëzit), e shikon si përpjekje për t'u bërë më pas i dobishëm për shoqërinë.

Çështja nuk është që të bëhemi zotërinjtë e njerëzve, por të jemi mes njerëzve duke u shërbyer atyre!.. Ajo që duhet të bëjmë kur të zgjedhim një jetë të tërhequr nga njerëzit, është të qenët në jetë për të zgjidhur ndonjë hall të vëllait në fe me ndjenjën e shërbimit fetar...

Myslimani është njeri që shqetësohet për të tjerët. Ai shqetësohet për vete dhe për të tjerët. Të gjithë duhet të jenë shumë mirë në çështjen e adhurimit, sepse myslimani është përgjegjës edhe për të tjerët aq sa është përgjegjës për veten e tij.

Myslimani i pranon si vëllezër myslimanët e tjerë dhe vepron me këtë vetëdije vëllazërore. Kudo qofshin vëllezërit e tij nëpër botë, gëzimi dhe fatkeqësia e tyre i intereson myslimanit. Myslimani nuk mund të jetë indiferent dhe nuk mund ta pranojë mendimin: "Gjarpri që nuk më kafshon mua, rroftë njëmijë vjet." Kur vëllait në fe i ngulet një gjemb në këmbë, ai vuan sikur t'i ishte ngulur në këmbë atij. Nuk mjafton vetëm të shqetësohemi, por duhet të përpiqemi për ta zgjidhur problemin.

Sot, koncepti i fqinjësisë dhe kriteret për të qenë fqinj kanë ndryshuar. Njerëzit mund të komunikojnë me njëri-tjetrin menjëherë kudo që mund të jenë në çdo anë të botës dhe të njoftohen për problemet që kanë. Në këtë botë që po zvogëlohet, po na shtohen edhe përgjegjësitë që kemi ndaj njëri-tjetrit. Shprehja

"afër", po bëhet e vlefshme edhe për vëllezërit që janë larg. Të gjithë ne njoftohemi për gjembin që i ngulet në këmbë myslimanit i cili është në anën tjetër të botës dhe ndjejmë dhimbje për këtë. Në çështjen e të ndjerit të dhimbjes së vëllezërve tanë, nuk kemi ndonjë justifikim.

Hadithi fisnik që do ta ndajmë me ju në këtë material, është një hadith fisnik që të gjithë e dimë... Një hadith fisnik që e dimë, por rëndësinë e të cilit në shumë aspekte nuk e kuptojmë.

Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

Ibn Abbasi, (r.a.), transmeton nga i Dërguari i Allahut, (a.s.):

"Ai që kalon natën i ngopur ndërkohë që fqinji pranë tij është i uritur, nuk ka besuar plotësisht." (Ibn Ebi Shejbe, Kitabu'l-Iman, fq. 33.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), në këtë hadith fisnik e mban shumë të gjerë kornizën. Ai thekson të drejtat e fqinjësisë me dy çështje kryesore që janë uria dhe të ngopurit.

Këto dy çështje kryesore mund t'i mbushim me shumë shembuj të urisë e të të ngopurit që kanë përmbajtje të ndryshme.

Uria materiale, uria shpirtërore, uria për dije, uria për informacion, privimi nga pasuria, uria shkencore dhe teknologjike, uria e virtytit dhe moralit, uria e vlerave shpirtërore, uria për njerëz të vlefshëm dhe të edukuar...

Një shembull i gjallë i këtij hadithi fisnik nën dritën e këtyre pikave që kemi cekur më sipër, është përjetuar ndërmjet nesh dhe vëllezërve tanë nga Azerbajxhani...

Përgjatë takimeve të ndryshme që bëri myftiu i krahinës Sheki të Azerbajxhanit kur vizitoi Turqinë në vitet nëntëdhjetë, në vizitën e një xhamie dëshmoi me admirim leximin e Kuranit Fisnik që bënin hafizët e Kuranit. I përlotur na kujtoi hadithin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.): *"Nuk është prej nesh ai që bie të flejë i ngopur, ndërkohë që fqinji i tij është i uritur"* dhe tha:

"Ju, vëllezërit e mi myslimanë! Këtu përjetoni gosti pas gostie shpirtërore. Ndërsa ne në Azerbajxhan me dhjetëra vite të tëra po përpëlitemi në urinë shpirtërore. Nëse nuk na dërgoni hoxhallarë dhe hafizë për të na mësuar fenë, në ahiret do të ankohemi te Allahu i Madhëruar për ju."

Këto fjalë të myftiut të nderuar të Azerbajxhanit që e godasin njeriun thellë në zemër, e hapën rrugën e fillimit të mësimit të Kuranit atje.

Ja pra, siç ndodhi në këtë ngjarje, uria nuk është vetëm materiale. Madje, uria shpirtërore është më e rëndësishme se uria materiale.

Po ashtu ka edhe uri që i djeg njerëzit, i lëshon në shtrat dhe së fundi i shpie drejt vdekjes. Ne habitemi kur dëgjojmë nga gazetat dhe televizori që njerëzit në Afrikë "vdesin nga uria".

Kështu që mendojmë: "Si ka mundësi që nuk gjejnë një kafshatë bukë? Ndërsa ne kemi bukë në shtëpi derisa thahet e tëra dhe e hedhim në koshin e mbeturinave. Si ka mundësi që nuk gjetkan dot një bukë?!"

Po, kjo është një uri që e shpie njeriun në varr... Një dramë njerëzore... Sigurisht se në vendin tonë tani ka filluar një mobilizim i ëmbël. Të gjithë po i bashkohen këtij mobilizimi pak nga pak dhe do vazhdojnë t'i bashkohen. Njerëzit e atjeshëm u ngopën sot, ndoshta do të ngopen edhe nesër... Po pastaj... Në momentin kur ata të bien nga interesimi ynë, përsëri ata njerëz do të lihen në fatin e tyre dhe do të harrohen.

Nëse marrëdhëniet dhe përgjegjësitë e fqinjësisë që shprehen në hadithin fisnik, i vlerësojmë si fqinj i dy shtëpive apo si fqinj i lagjes, atëherë çështjen e kemi parë nga një këndvështrim i cekët. Shumë vende të Afrikës në të cilat dominon uria sot, së pari prej nesh presin lutje dhe pastaj ndihmë materialo-shpirtërore. Ata janë fqinjët tanë... Ndoshta nuk janë fqinjët tanë të afërt, por janë fqinjët që të paktën i njohim siç njohim brendësinë e shtëpisë sonë...

Allahu Teala na mundësoftë që të njoftohemi për të gjithë fqinjët qofshin afër apo larg dhe për t'i ndihmuar ata në hallet e tyre.

Lutja jonë:

"O Zot! Më bëj të jetoj përderisa e sheh të mirë jetën për mua me dijen Tënde të gajbit dhe me fuqinë Tënde mbi krijesat. Po ashtu, më bëj të vdes kur e sheh se vdekja është më e mirë për mua.

O Zot! Të lutem më jep frikërespekt ndaj Teje kur jam vetëm dhe kur jam me të tjerët. Të lutem mos më ndaj nga fjala e sinqertë kur të jem i (e) kënaqur dhe kur të jem i (e) zemëruar. Të lutem mos më ndaj nga normaliteti kur të jem i (e) varfër dhe kur të jem i (e) pasur.

Kërkoj prej Teje një mirësi të pashterueshme dhe një kënaqësi të pandërprerë. Kërkoj që të më bësh të kënaqur ndaj caktimit Tënd dhe freskinë e jetës pas vdekjes. Prej Teje kërkoj kënaqësinë e shikimit të bukurisë Tënde dhe dëshirën për t'u takuar me Ty.

Të lutem që të gjitha këto të m'i japësh duke më mbrojtur prej zararit të tyre dhe larg përçarjeve devijuese. O Zot! Na zbukuro me stolinë e besimit dhe na bëj udhëzues për në udhëzimin Tënd që është rruga e drejtë. Amin!" (Nesai, Sehv, 62/1303; Ahmed, IV, 264.)

Elif Menxhel

Fjalët e një gjembi

Jeta jonë ka aq shumë detaje... Ashtu siç një rrobe të cilën e kemi përdorur për vite me radhë me kalimin e kohës nuk i ngelet asnjë kuptim, ndonjëherë një gjë fare e parëndësishme, ose së cilës deri atë çast nuk i kemi dhënë rëndësi, papritur për ne mund të shprehë shumë gjëra.

Në kohën kur komunikimi ishte shumë i vështirë dhe kësaj i shtohej edhe varfëria e skamja, për të mundësuar të ardhurat njerëzit ishin të detyruar të shkonin në vende të largëta. Ata kanë ndenjur për vite me radhë të ndarë nga shtëpitë dhe vatrat e tyre.

Pikërisht në kohën kur thuhej "Ç'është kjo punë? Kush ikën, nuk kthehet më", dy shokë nga i njëjti fshat u nisën për në kurbet për të kërkuar punë. Për të mos u kthyer në fshat duarbosh ata punuan natë e ditë dhe mblodhën para. Më në fund thanë "mjaft" dhe vendosën të kthehen së bashku në fshatin e tyre. Pas një udhëtimi të gjatë dhe të vështirë, të emocionuar se do të bashkoheshin me fshatin dhe njerëzit e tyre të dashur, u ndalën për të pushuar pranë një burimi.

Pasi pushuan pak, Fatihu u ngrit në këmbë dhe i shkoi përballë shokut të tij me një thikë në dorë duke i thënë:

"M'i jep menjëherë paratë!.."

Sulejmani i tha i habitur:

"Po bën shaka? A nuk jemi shokë bashkë? Kemi kaluar bashkë fëmijërinë, rininë, madje edhe punën e kemi bërë bashkë. Sa e sa vështirësi kemi kaluar së bashku! Ç'të keqe të kam bërë?"

Ndërsa Fatihu me shumë vendosmëri dhe ashpërsi, ia bëri të qartë qëllimin që kishte duke i thënë:

"Po, ato që the janë të vërteta, por unë tani dua të të vras, të t'i marr paratë dhe kur të kthehem në fshat, të marr zonjën tënde së cilës ka vite që ia kam vënë syrin!.."

"Po mirë, kur të të pyesin në fshat për mua, çfarë do t'u thuash?"

"Do t'u them se vdiqe nga sëmundja."

"Si do t'ua vërtetosh se kam vdekur nga sëmundja?"

"Nuk ke asnjë dëshmitar. Kështu që ata nuk do të të besojnë."

"A nuk ke frikë aspak nga Allahu?!.."

Fatihu nuk e la të fliste më shumë dhe e lidhi këmbë e duar Sulejmanin. Në atë çast fryu një erë. Nga pemët ranë gjethe dhe bari u përhap përreth. Gjembat e rrumbullakët që quheshin "ylingir", u përdrodhën rreth tyre. Sulejmani, duke parë gjembat që rrotulloheshin përtokë, tha me dhimbje:

"Ky gjemb me lejen e Zotit do të dëshmojë për mua..."

Burri i tërbuar qeshi aq shumë me këtë fjalë... Pastaj duke thënë:

"Një gjemb... Nuk e dija se je kaq budalla!..", e vrau shokun e tij pa iu dridhur qerpiku. Ia mori paratë dhe sendet që kishte, e varrosi trupin aty dhe u kthye në fshat.

Të gjithë që e njihnin, pasi i thanë "Mirë se erdhe!", e pyetën për Sulejmanin me të cilin kishte dalë për rrugë. Ai të gjithëve u dha të njëjtën përgjigje. Lajmi i zi u përhap menjëherë. Gruaja e Sulejmanit e cila priste lajm nga ai, vajtoi shumë dhe e dëshpëruar e pranoi vdekjen e burrit të saj duke thënë "Kaderi im!.."

Pas një kohe Fatihu tha se dëshironte të martohej me gruan e të ndjerit Sulejman. Këtë e panë të përshtatshme edhe fshatarët të cilët e bindën gruan duke i thënë "Ti je e re. Duhet ta jetosh jetën!..". më në fund u martuan.

Një ditë, ndërsa po rrinin në një vend me kopshte e vresht dhe Fatihu e kishte mbështetur kokën te prehri i gruas, filloi të frynte një erë e lehtë. Burri qeshi me të madhe. Gruaja pa rreth e rrotull e habitur, por nuk kishte njeri. Nuk kishte ndonjë gjë për të buzëqeshur e për më tepër për të qeshur me të madhe. U bë kurioze dhe e pyeti se pse qeshi kaq shumë...

"S'ka gjë" i tha Fatihu.

Gruaja këmbëngului dhe i tha:

"Si asgjë? Gjithë ky gaz duhet ta ketë një shkak. Ma thuaj të qesh edhe unë."

Edhe pse burri i tha:

"Është histori e gjatë..." dhe u mundua ta kalonte, gruaja i tha:

"Kam kohë, mund ta dëgjoj."

Fatihu i tregoi duke qeshur për erën, vdekjen e Sulejmanit dhe se si një gjemb do të dëshmonte për këtë ngjarje. Vazhdimisht qeshte me të madhe dhe thoshte:

"Do të dëshmuaka një gjemb, sa komike?!"

Gruaja e shkretë u habit shumë. Ajo i dëgjoi fjalët e tij pa ndërprerje me shumë interes. Pas kësaj ajo pa e bërë të gjatë u ankua për Fatihun te autoritetet përkatëse dhe Fatihu hyri në burg për vrasjen e Sulejmanit. Kështu u plotësua edhe dëshmia e një gjembi.

Nëse do Allahu, i bën të dëshmojnë për ne krijesa të gjalla e jo të gjalla. Më parë nuk ka pasur radio e televizorë. Kur mblidheshin familjet, të afërmit dhe fqinjët, tregonin ngjarjet interesante që u kishin ndodhur ose ngjarje që i kishin dëgjuar apo parë. Të gjithë, i madh dhe i vogël, dëgjonin me vëmendje dhe merrnin mësim nga ajo që tregohej. Në këtë mënyrë, të paktën mësonin si të qëndronin me respekt pranë të mëdhenjve dhe si ta dëgjonin me vëmendje atë që fliste. Kur shkoja te gjyshi, ai lexonte me një dëshirë të madhe klasikët e lindjes dhe na i transmetonte ndodhitë sikur t'i kishte përjetuar vetë.

Sigurisht se disa fjalë nuk i kuptonim, por ai na i shpjegonte në një mënyrë të kuptueshme. Admirimi im ndaj "Bostanit" e "Gjylistanit" të Sheh Sadit dhe ndaj tregimeve mësimdhënëse të Hazreti Mevlanës, e ka zanafillën në ato kohë. Unë e kujtoj gjyshen time duke i kërkuar mëshirë Allahut për të që më tregoi këtë histori dhe duke nxjerrë një mësim nga ky tregim, them:

"Mirësia dhe ligësia nuk humbin asnjëherë. Herët apo vonë e gjejnë vendin e tyre dhe vjen një ditë që dalin në pah. Të mirët marrin shpërblimin, ndërsa të këqijtë marrin atë që kanë merituar."

Servete Dërguti

Zëri i lutjes

Ishte viti 1994. Shqipëria, vendi im i shtrenjtë, sapo kishte filluar të merrte frymë lirisht. Era e demokracisë kishte fryrë ngado dhe gjethet e kalbura të pemës gjysmëshekullore ishin derdhur në tokën e tharë që kishte rënkuar për kaq e kaq dekada.

Të gjithë ndiheshin të lumtur dhe të gëzuar. Kishte filluar një jetë e re. Gjërat kishin filluar të ndryshonin. Besimi i njerëzve në fuqinë e Zotit sa vinte e rritej. Ekonomia e vendit, për pak kohë, kishte pësuar ndryshime të dukshme.

Tregjet e qytetit tim filluan të ndryshonin. Përveç ushqimeve të shumta, në treg kishte edhe fruta të ndryshëm, që të çonin gojën lëng tek kaloje andej dhe i shikoje me ato ngjyrat e tyre rrëzëlluese, pale aromat dehëse, të cilat të krijonin ndjesinë e ngopjes dhe të të fiktit nga uria njëherësh.

Qytetarë të ndryshëm blinin të lumtur këto produkte dhe secili në gjuhën e shpirtit të vet falënderonte Zotin për mrekullinë që kishte ngjarë në këtë vend të lodhur për shumë vite nga uria, por me një shpirt të madh e luftarak e kishte superuar këtë vështirësi.

Por më e mrekullueshmja ishte atëherë kur thirrej ezani i namazit. Njerëz të moshave të ndryshme ndalonin në vend dhe prisnin përfundimin e ezanit për t'u drejtuar nga faltoret që të falnin namazin. Akoma nuk kishin filluar të ndërtoheshin xhamitë e reja. Edhe ato pak xhami që kishin shpëtuar pa u shkatërruar tërësisht, kishin nevojë të restauroheshin, ndaj namazi falej në vende të caktuara, të cilat mbusheshin plot e përplot me fëmijë, të rritur dhe të moshuar.

Në mes tyre ishte edhe një djalë i vogël që quhej Ditjon. Pasi përfundonte namazin, kthehej në shtëpi për të përmbushur detyrat e tij.

Ai jetonte me të ëmën në një shtëpi të vogël përdhese. I ati kishte ndërruar jetë nga një sëmundje e

rëndë pak muaj para se të vinte Ditjoni në jetë.

Kur e shikoje në rrugë, ashtu të dobët dhe të zbehtë, mendja të shkonte te "Luli i vocërr". Të dukej sikur Migjeni jetonte në këtë shekull me vuajtjet e një Luli tjetër.

Drejtohej për në shtëpi, me këpucët e shqyera që të dukej sikur hapnin gojën të të hanin, pantallonat me arna të shqyera, e me një bluzë me mëngë të përveshura.

E priste nëna...

Sapo hynte në shtëpi, djali përshëndeste nënën e tij, i puthte duart e saj të thara dhe e pyeste nëse kishte ngrënë ndonjë gjë. Mezi i mbante lotët. E dinte se ç'kishte në shtëpi.

Kalonte përgjatë tregut, kundronte aromat e frutave, por...nuk mund t'ia sillte edhe nënës aromën e tyre, nuk mundte, nuk mundte, nuk..., nuk...

Ishte shumë i vogël për të gjetur një punë. Jetonin vetëm me një shumë mospërfillëse të ndihmës ekonomike. Ç'të blinte më parë me të? Të merrte ilaçet e nënës, të blinte bukë, të paguante dritat?! Por për frutat, as që bëhej fjalë.

Ditët pasonin njëra-tjetrën dhe nëna përkeqësohej edhe më shumë nga shëndeti. Duhej të fillonte doemos punë. Trokiti derë më derë dhe më në fund gjeti një punë.

Një njeri shpirtmirë i dha një pako me cigare dhe disa çamçakizë t'i shiste që të fitonte sadopak. I mori ato dhe i vendosi në një kuti. Mori bekimin e nënës dhe doli nga shtëpia.

Shëtiti të gjitha rrugët e qytetit me mendimin se do të shiste diçka. Fati nuk i eci. U kthye pak pa u errësuar. Ishte i dërrmuar nga lodhja, po brenga e shkatërronte më shumë.

Të nesërmen u zgjua herët, përgatiti trahananë dhe ia dha nënës për mëngjes, mori bekimin e saj dhe u nis për punë. Dita ishte shumë e lodhshme, ama, për Ditjonin, ishte një ditë e re e mrekullueshme, sepse mundi nuk i shkoi kot. Kishte fituar disa të holla. Me të shpejtë u nis drejt tregut. Shpejtonte hapat të arrinte të gjente ndonjë tezgë hapur që t'i blinte nënës ndonjë frut.

Ishte thuajse ora katër e pasdrekes. Në qoshen e tregut ishte një tregtar që rrinte më vonë se të tjerët hapur. Arriti të blinte dy kokrra mollë. Mollët kundërmonin aromë shumë të këndshme. Ditjoni mori mollët dhe shpejtoi për në shtëpi. Këmbët i fluturonin. Arriti te dera e shtëpisë dhe çuditërish u ndal. Dera e shtëpisë ishte pak e hapur. Hyri me një frymë. Në shtëpi kishte rënë heshtja. Thirri nënën, por më kot. U afrua pranë krevatit të nënës. Filloi ta thërriste më fort, por asnjë pipëtimë. Mollët i ranë nga duart dhe u përplasën në dysheme duke u rrokullisur. Me zor po mbushej me frymë. Ishte mbushur në djersë të ftohta. Këmbët dhe duart filluan t'i dridheshin. U ul në gjunjë pranë kokës së nënës dhe filloi ta tundte e ta thërriste, por më kot. Nëna ishte ngrirë. Trupi i saj pa jetë dergjej në shtrat. Mollët dergjeshin përtokë të shpërndara në dysheme. Ditjoni shikonte njëherë nënën e ngrirë dhe njëherë mollët. Filloi të qante me të madhe dhe shtrëngonte fort trupin pa jetë të nënës.

Ajo nuk i shijoi mollët që i solli djali. Nuk mundi të shijonte frytin e parë të punës së djalit të saj.

Komshinjtë dhe të afërmit e morën lajmin e hidhur nga të qarat e djalit dhe menjëherë iu gjendën pranë. Nënës iu dha lamtumira e fundit. Ditët kalonin dhe Ditjoni rritej e burrërohej. Punën që filloi nuk e la për asnjë çast. Në shkollë ishte shumë mirë me mësime. Asnjëherë nuk i linte pasdore mësimet. Çdo ditë të premte, Ditjoni blinte dy kokrra mollë dhe shkonte pranë varrit të nënës së tij për vizitë. Zemra i rrihte me forcë. Bekimi i nënës e ndiqte në çdo hap që hidhte. Zoti i madh kishte dëgjuar lutjet e saj.

Aishe Tunçajak

Bëj një ushqim të tillë që...

Çdo vajzë është kandidate për t'u bërë zonjë. Disa në fakt edukohen si zonja të vogla. Bëjnë çdo punë që munden. Janë sundimtare të kuzhinës dhe numër një në pastrim... Dikush di qepje e qëndisje, disa pajën e bëjnë me duart e tyre.

Ndërsa disa të tjera rriten si unë duke mos e ditur nga bie kuzhina. Ndërkohë që moshataret e tyre përparojnë në rrugën për t'u bërë zonja, ato për shembull vrapojnë pas topit. Kanë vetëbesim aq të lartë saqë bëjnë projekte të reja për të shpëtuar botën. Kanë mbledhur këshillin dhe nuk shkojnë as për të ngrënë ushqim.

Nuk e di nëse është nga natyrshmëria, apo roli i gruas, por herët ose vonë e gjeni veten në kuzhinë. Të paktën kur martoheni... Hyrja e parë për mua në kuzhinë ndodhi në vitet e shkollës kur u ndava nga konvikti dhe dola në shtëpi. Për herë të parë kam gatuar në shtëpinë e shoqeve të mia... Mos u merakosni, të gjitha ishin të shëndetshme. Nuk isha edhe aq keq.

Pastaj u martova. Nuk kishte më radhë. Çdo ditë isha e detyruar të gatuaja vetë dhe në përfundim të aventurave të kuzhinës, vura re se ushqimi ka një shpirt, sepse çdo gjë, që nga marrja e ingredienteve, gjatë përgatitjes dhe deri te ngrënia e tij, ushqimi ndikon te shpirti i njeriut.

Ne, si krijesa fizike, zakonisht mendojmë vetëm trupin dhe nuk i kushtojmë aspak rëndësi anës shpirtërore. Madje nuk na bie në mendje për ekzistencën e shpirtit. Mundohemi të ushqehemi në mënyrë të shëndetshme që të kemi trup të shëndetshëm, por nuk bëjmë kujdes për shëndetin e zemrës, shpirtit.

Tashmë të vijmë te çështja se si ndikon një ushqim te ne...

Së pari, që ingredientët të vijnë në shtëpi, duhen para dhe që këto para të jenë hallall, është faktori i parë dhe më i rëndësishëm... Në këtë kohë nuk është shumë e rëndësishme se si fitohet paraja... Madje shumë njerëz nuk janë as në dijeni të haramit që

bëjnë... Aq shumë është kthyer në normale....

Për shembull dikujt që thotë:

"Unë nuk dua të fitoj para duke gënjyer njerëzit", mund t'i thuhet:

"Ti mos gënjej, bëj blof!.."

Pastaj gënjeshtra ka edhe ngjyra. Nëse është e bardhë apo rozë, nuk ka problem. Sigurisht duhet të shohim se si duken këto ngjyra nga sytë e atyre që gënjejnë dhe si i shikojnë pala tjetër. Shkurtimisht në këtë kohë është shumë vështirë të gjesh tregtar të drejtë. Sidomos kur atyre u duken normale ato që bëjnë...

Ushqimi hallall e qetëson shpirtin. Ndërsa ushqimet haram bëhen shkak për pakujdesi dhe shqetësim. Prandaj njeriu nuk mund të qëndrojë pa pyetur nëse ky është një nga shkaqet që psikologët kanë filluar të fitojnë shumë para...

Hz. Abdulkadir Gejlani, në çështjen e ushqimit haram, thotë:

"Ushqimi haram e vret zemrën. Ka kafshata që e ndriçojnë zemrën, por ka kafshata që e mbysin atë në errësirë. Ka kafshata që të bëjnë të preokupohesh me këtë botë; ka edhe kafshata që të bëjnë të punosh për ahiretin."

Një nga të mëdhenjtë, Ibrahim Dussuki, kuddise sirruh, thotë:

" O vëllezër! Mos pandehni se do të fitoni ndonjë mirësi dhe dije sa kohë që hani ushqim haram!"

Këto mund t'i shumosh, por mjafton për ata që kanë mend. Në fakt mendjelehtëve çfarëdo që t'u thuash, është e kotë...

Ndjeshmëria që kanë njerëzit e devotshëm në çështjen e ushqimeve, i ka bërë ata që t'i bartin për në shtëpi ushqimet që blejnë në mënyrë të mbyllur, sepse sytë e njerëzve nuk duhet të shikojnë asnjë ushqim që merret për në shtëpi dhe në energjinë e fuqinë që shpresohet prej këtyre ushqimeve, nuk duhet të gjenden ndikimet negative të brengosjeve të nevojtarëve dhe shikimeve të pikëlluara të të varfërve dhe të të privuarve.

Kjo e bën të domosdoshme mbajtjen fshehtë sa të jetë e mundur të ushqimeve që blejmë. Në fakt, ngaqë shumicën ose një pjesë të pazarit e bëjmë patjetër në supermarkete, nuk kam ndonjë mendim në çështjen se "Sa e mundur mund të jetë kjo?", por ia vlen ta provosh.

Pas këtyre fazave i vjen radha përgatitjes së ushqimit... Dhe nuk ka pyetje më irrituese se pyetja "Çfarë do të gatuaj sonte?". Unë ju këshilloj që të kërkoni ingrendientët për ushqimin që ju vjen në mendje dhe të gatuani ushqim sipas ingrendientëve që keni në shtëpi!.. Nëse nevojitet, është më logjike të trilloni diçka... Kështu nuk dridhet as buxheti juaj, as ju.

Ndërkohë që i qëroni, prisni apo i lani ingrendientët, nuk duhet t'i shpërdoroni në mënyrë që të mos largohet bereqeti i shtëpisë. Madje gjërat që mendoni se duhet të hidhen, mund t'i përdorni për diçka tjetër. Sidoqoftë le të flasim për shpirtin.

Gjendja juaj shpirtërore është shumë e rëndësishme që nga fillimi i ushqimit e deri te përgatitja e tij... Sepse të gjithë e kemi dëgjuar historinë e Hizrit, alejhisselam dhe Abdulhalik Gyxhdevanit, kuddise sirruh.

Hizri (a.s.), nuk e hëngri ushqimin që i dha ky mik i Allahut. Gyxhdevani e pyeti:

"Ky është ushqim hallall, pse nuk e hani?"

Hizri, alejhisselam, u përgjigj:

"Po, ushqim hallall është, por ai që e ka gatuar, e ka përgatitur me zemërim dhe pakujdesi."

Në fakt, ngaqë shumë njerëz në ditët e sotme ushqehen me "fast food", ndoshta nuk mund të themi: "Zotëri, kur e përgatite këtë hamburger, a ishe i pakujdesshëm apo plot mendjemadhësi? Në çfarë gjendjeje e përgatite?"... Këtë pyetje nuk mund ta bëni as kur shkoni diku si mysafir. Por, duke i zgjedhur njerëzit me të cilët do të qëndroni, pra duke qëndruar me besnikët dhe duke ngrënë ushqimet që gatuan nëna me dashuri, mund të bëni kujdes më mirë për këtë.

Për shembull mua kjo më pëlqeu shumë. Kur të gatuani, ju lutem "bëjini dhikër Allahut!"... Që nga kjo të përfitoni ju dhe pjesëtarët e familjes... Madje nëse jeni zënë me bashkëshortin, thoni "Ya Vedûd" dhe me lejen e Allahut, rregullohet çdo gjë... Nëse Ai nuk e lejon, sigurisht që ne nuk mundemi për asgjë. Thoni "la ilahe ilallah" që fëmijëve tuaj, ashtu siç ushqeni trupin, t'u bëhet shëndet për shpirtin inshallah...

Dhe ushqimi është gati. Tashmë është koha të ulemi në tavolinë. Këtu është e rëndësishme që pjesëtarët e familjes të ulen në një tavolinë aq sa kanë mundësi... Kjo e shton dashurinë në familje.

Pastaj thënia "Bismil-lah" në fillim të ushqimit dhe "Elhamdulil-lah" në fund të tij, e shton bereqetin e sofrës, e largon shejtanin. Veçanërisht atij që thotë Besmelenë në fillim të ngrënies dhe Elhamdulil-lah në fund, i falen mëkatet akoma pa u ngritur nga tavolina. (Taberani)

Shkurtimisht njeriu nuk është vetëm qenie fizike. Edhe djalli ka parë vetëm anën fizike të njeriut dhe është bërë mendjemadh. Ai nuk e ka vënë re atë xhevahir të pafund që ka përbrenda. Djalli nuk ka mundur ta kuptojë, të paktën të mos biem në të njëjtin gabim edhe ne të cilët e bartim këtë xhevahir i cili do të na çojë ne në pafundësi...

Rushan Kavallë

Bakllavaja

Bakllavaja është një ëmbëlsirë turke, së cilës i kanë dalë për zot shumë krahina dhe e quajnë të tyren. Historia e saj arrin deri tek asirianët e lashtë. Ajo bëhet duke vendosur mes petave të holla, sipas krahinave, arra, stika, lajthi...etj.

Sipas shijes së sherbetit dhe içit, përmenden lloje të ndryshme bakllavashë. Me rastin e ditëve të veçanta, të ftesave për iftare ose të bajrameve, na kap një telash i ëmbël. Në fakt, nuk është dhe shumë e vështirë të bësh bakllava. Këtë mund ta vëreni, në qoftë se e praktikoni recetën shkallë- shkallë. Tani le të kalojmë te receta:

PËRBËRËSIT PËR BRUMIN

2 vezë
Miell për bakllava
2 lugë uthull
Pak kripë
1 gotë uji qumësht i ngrohtë
Maja
Një gotë çaji gjalpë i shkrirë
Pak niseshte

IÇI

Arra, lajthi ose stika
250 gramë gjalpë i shkrirë

PËR SHERBETIN

5 gota uji sheqer
3.5 gota uji ujë
Gjysmë limoni

Në enën ku do të përgatisim brumin hedhim vezët, qumështin, gjalpin, uthullën dhe kripën dhe i rrahim. U hedhim miell dhe e mbrujmë, deri sa të bëhet një brumë i ngjeshur. Brumi ndahet në copa në madhësinë e një arre dhe lihet të pushojë.

Më vonë, fillojmë t'i hapim me okllai, duke përdorur nisheste dhe i hapim deri në madhësinë e një pjate gjelle. Duke vendosur nisheste mes tyre, vendosim 16-18 peta një mbi një. (Sipas dëshirës mund të bëhen dhe nga një dhjetëshe peta bashkë.) Në këtë mënyrë, përftohen tre grupe prej 16 petash.

Tepsia lyhet me gjalpë. Merret një grup 16 petësh dhe hapet në gjerësinë e tepsisë. E shtrojmë në tepsi dhe sipër i hedhim gjysmën e arrave. Hapet dhe grupi i dytë dhe sipër i hedhim arrat e mbetura. Së fundi, hapet dhe grupi i tretë dhe e vendosim sipër. Bakllavaja pritet në formën e saj karakteristike. Pastaj sipër i hedhim gjalpin e nxehtë, në mënyrë që të përhapet në çdo anë. E pjekim në furrë në 200 gradë, deri sa të skuqet përsipër.

Ndërkohë që bakllavaja piqet, vendosim në një tenxhere sheqer, ujë dhe lëkurë limoni të grirë dhe për 15-20 minuta e ziejmë deri sa të marrë trajtën e ajkës.

Pasi piqet, bakllavaja nxirret nga furra dhe lihet të ftohet. (Sipas dëshirës, për një sipërfaqe sa më të shndritshme mund ta lyejmë sipërfaqen e bakllavës me yndyrë). Në këtë moment i hidhet sherbeti i nxehtë. Bakllavaja duhet të serviret pasi ta thithë mirë sherbetin.

Shënim: Petat mund të hapen dhe një nga një. Hapja një nga një ia shton bukurinë dhe shijen.

Këshillat për një bakllavë të lezetshme:

-Mënyra e parë për të pasur sukses në bërjen e një bakllavaje të mirë është përdorimi i produkteve të freskëta dhe cilësore. Veçanërisht, mielli duhet të jetë miell bakllavaje i klasit të parë.

-Sa më e hollë që të hollohet peta, aq më e mirë vjen në gojë bakllavaja.

-Sasia e nishestesë duhet të rregullohet mirë, nishesteja e tepërt e than brumin.

-Vezët e tepërta vështirësojnë hapjen e brumit.

-Gjatë pjekjes duhet të kemi kujdes nxehtësinë, sepse bakllavaja nuk duhet tharë shumë.

-Brumi nuk duhet zënë shumë i fortë.

-Sherbeti duhet të jetë më viskoz (i trashë) se i ëmbëlsirave tjera.

-Në qoftë se gjatë pjekjes kapaku i furrës hapet herë pas here, do të kemi qarkullim të ajrit, çka do të sigurojë pjekjen e pjesës së brendshme të brumit.

-Sherbeti duhet të jetë i nxehtë dhe bakllavaja e ftohtë.

-Bakllavanë mund ta ruajmë për një kohë pa ia hedhur sherbetin. Kur të duam t'ia hedhim sherbetin, mund ta ngrohim pak në furrë, në mënyrë që bakllavaja ta thithë më mirë atë.

I dashur Njeri

Eci e menduar në rrugët e shtruara me gjethe të thara vjeshte; re të hirta fillojnë të mbulojnë qiellin e mendimeve të mia dhe unë e heshtur mes pikëpyetjeve të të jetuarit rrekem të gjej paqen shpirtërore, por mjegulla e materializmit tënd është e dendur dhe nuk më lë të shoh qartë, veçse dëgjoj rrahjet e shqetësuara të zemrës së kësaj bote…ndaj më duhet të të shkruaj:

I dashur njeri,

Po lëkundem si një gjethe, po largohem si një kokrrizë rëre, era e materializmit tënd po fryn furishëm drejt meje, etja jote po përpin gjithë lëngun e jetës duke të të shndërruar në një qenie pa jetë dhe unë po bie, po largohem pa dashur nga ti njeri.

Je krijesa më e lartë e Tokës, të cilën Krijuesi e përsosi në krijim dhe engjëjt t'u përulën me urdhrin e Tij; t'u mbush bota me çdo gjë që kishe nevojë, duke të të vënë në shërbim mirësitë e pafundme të më të Lartit dhe t'u dha gjithçka me vete në udhë.

Por përse po jepesh kaq shumë për të përkohshmen duke harruar të përjetshmen? Përse shfrytëzon mirësitë e Zotit dhe harron falënderimin ndaj Tij? Përse do materialen para shpirtërores? Përse do formën dhe jo përmbajtjen? Përse do asgjënë para gjithçkasë? Përse…?

Unë jam fryma jote hyjnore që jetëson materializmin tënd duke të të shndërruar në qenie. E ke pyetur veten se çfarë je pa mua…pa mua…pa mua?!

I dashur njeri, je udhëtar mes dimensionesh të krijuara për ty: kohës dhe hapësirës, jetës dhe rrugës udhëtare. Këto dimensione u krijuan për ty njeri dhe janë vetëm sepse jam unë!

Je krijuar për të jetuar i plotë, je shkëmb bregdetar përballë dallgëve të jetës, mos u shndërro në rërë!

Përpjekja jote "kohë e gabuar, vend i gabuar" është përpjekje që të çon drejt errësirës duke të të bërë të harrosh mirësitë e pafundme të Zotit tënd, mëshira e të Cilit përfshin çdo gjë e më së shumti ty qenie gabimtare që po harron shpirtin tënd… Sa dhimbje!

I dashur njeri, nëse udhëtimi të lodh, kujtohu se e ka një fund, i cili është fillimi i përjetësisë, mendo si do e doje përjetësinë tënde?!

I dashur njeri, kur të duash të ndalesh dhe të kthesh kokën pas për t'u kredhur në të kaluarën, mjaftohu me mësimet e saj, mos u tret nga shija e thartë e kujtimeve. Të lutem ji i vërtetë, se e vërteta i përfshin të gjitha, jeto të tashmen sepse vetëm ajo është jotja!

Përse e harron atë emocionin e madh që të lumturonte pa masë… takimin me Krijuesin, gjithmonë mes frikës e shpresës? Mendo se çfarë vërtet ka rëndësi, a harron vlerat e larta që fillojnë tek unë dhe në audiencën e Kujt janë?!

I dashur njeri, a harrohem unë? Rojtari i vlerave dhe i dashurive të mëdha, pasuria që mbush zbrazëtinë e materiales, përjetësia jote, fryma hyjnore?!... I dashur njeri, mos vdis pa ikur unë!!!

Me mall, Shpirti

Duke lënë mjegullën pas, kthehem nga arratia në krahët e mendimit dhe vazhdoj të hedh hapat si udhëtare e kësaj bote të stuhishme me besim për të mbajtur të pashuar dashurinë për Krijuesin, i Cili krijoi çdo gjë.

Ela Muça

PROGRESI
BOTIME

Arsyeja dhe Filozofia

I RI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË RINJ

SHQIPËRI: Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 607 8484 | E-mail: revistaetika@progresibotime.com
KOSOVË: Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 4411 9848
MAQEDONI: Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245

Prodhimet me të cilat kemi fituar SHPËRBLIMIN KOSOVAR TË PRODUKTIT TË QUMËSHTIT 2005

KONSUMONI PRODUKTE ME CILËSI TË VËRTETUAR

CILËSI E VËRTETUAR

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

Adresa-Address:"Tirana" N:9, Prizren
Tel & Fax: +381 29 622 356
E-mail:abi@abimilk.com

www.abimilk.com

"ABI" është licensuar nga ana e Agjencisë Veterinare e Ushqimit të Kosovës
Numri i licencës : AVUK-001
"ABI" ka fituar të drejtën për eksport me numrin eksportues : KS-033